

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5645
E mërkurë, 5 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Ambasadori i ri
amerikan vazhdon
takimet njoftuese me
zyrtarët e Kosovës | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**TRANSFORMIMI
I FSK-së NË
USHTRI DO T'I
KONTRIBUOJË
PAQES NË RAJON**

F. 11



Ramadan AVDIU

**BACË ADEMI
DEMAÇI, KUSH
TA UROJË 28
NËNTORIN?**

F. 11



Salihe SALIHU, PhD
dhe veprimtare

**NUK MBAHET SEANCA E
JASHTËZAKONSHME E
THIRRUR NGA OPOZITA**

F. 7

EKONOMI

**BERZH-i NDAN 17.6 MILIONË
EURO PËR HEKURUDHËN
FUSHË-KOSOVË - MITROVICË**

F. 9

**MINISTRI SHALA:
MOSNJOHJA E KOSOVËS
ËSHTË PENGESA MË E MADHE
JOTARIFORE NË CEFTA**

F. 8

KULTURË

**SESION SHKENCOR
KUSHTUAR 70-VJETORIT
TË LINDJES SË PROF.
DR. TAFIL KELMENDIT**

F. 10

SPORT

**DRITA "HARRON" TITULLIN,
FOKUSOHET PËR KUPË**

F. 18

**KELMENDI: NË KOSOVË TË
GJITHË PRESIN NGA UNË
VEÇ MEDALJE TË ARTA**

F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", VIGAN QORROLLI | FAQE 4-5



Faji për mosliberalizim të vizave është i dyanshëm

Njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, fajin për mosliberalizimin e vizave për Kosovën ua ka hedhur institucioneve të Kosovës dhe të BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

vlërësuar se asnjëra palë në këtë proces nuk ka qenë korrekte. Qorrolli ka bërë me dije se institucionet vendore kanë përgjegjësi për mospërbushjen e kriterit për luftimin e krimit dhe korrupsionit

ndërsa, sipas tij, BE-ja është përgjegjëse për vendosjen e kriterëve jo të arsyeshme për Kosovën në këtë proces. Qorrolli ka shprehur skepticizëm se do të mund të bëhet diçka në këtë proces gjatë vitit 2019

Haradinaj: Taksa 100 për qind nuk hiqet



Qeveria e Kosovës nuk ka lëvizur nga vendimi për vendosjen e taksës prej 100 për qindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Kështu ka deklaruar të martën kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë me gazetarë.

Ai ka thënë se, pavarësisht prej tendencave, taksa nuk do të hiqet dhe, sipas tij, nëse dikush i ka borxhe Serbisë, t'ia lajë në mënyra të tjera. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se taksa ndaj produkteve serbe nuk ka të bëjë me liberalizimin e vizave

FAQE 3



**KDI-ja u
bënë thirrje
partive të
arrijnë
konsensus
politik për
dialogun
Kosovë - Serbi**

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Po s'e kandidoi në Tiranë, Veliaj i merr partinë Ramës?

TIRANË, 4 DHJETOR - Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, është vlerësuar gjerësisht për investimet në kryeqytet gjatë mandatit të tij të parë dhe e ka shprehur hapur dëshirën për të rikandiduar në zgjedhjet e 30 qershorit 2019. Por, në terrenin

mediatik janë duke qarkulluar zëra se mund të mos jetë Veliaj i përzgjedhuri i kryeministrit Edi Rama për Bashkinë e Tiranës dhe është përfolur për emrin e ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, kandidate potenciale. Edhe pse asgjë nuk

është e konfirmuar, kjo çështje ka hapur debat dhe për të ka folur edhe ministri i Diasporës, Pandeli Majko, i cili është një nga njerëzit e besuar të shefit të qeverisë dhe Veliajt njëkohësisht. Lidhur me kandidimin ose jo të Erjon Veliajt për kryebashkiak,

Majko ka thënë: "Nuk kam informacion, e kam dëgjuar si thashetheme. Por mendoj se Rama do dëmtonte veten më shumë sesa Erionin". Ndërkohë, sa i përket rrezikut që i vjen Edi Ramës nga Erion Veliaj, i cili "kërkon" t'i zërë vendin si



kryetar i Partisë Socialiste, Majko ka thënë se kjo nuk ka shans të ndodhë.

Ministrja Hoxha: BE-ja të mos i mbajë të izoluar qytetarët e Kosovës

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në takim të nivelit të lartë në Bruksel, ka shprehur brengën që Kosova është i vetmi vend i izoluar në Ballkanin Perëndimor që ka vetëm MSA-në e nënshkruar, duke vënë në dukje gjasat e vogla që Kosova së shpejti të ketë një perspektivë evropiane

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, po merr pjesë në takim të nivelit të lartë në Bruksel, nën organizimin e "Friends of Europe", me temën "BE-Ballkani Perëndimor: Zgjerimi, integrimi dhe sfidat e transformimit". Procesi i integritimit evropian është një nga qëllimet kryesore të vendit tonë, pasi kemi vlerat dhe parimet e përbashkëta të Evropës, vuri në dukje ministrja Hoxha në fjalën hyrëse. "Nuk ka dyshim se ne jemi patjetër vendi më pro evropian në Evropë", ka potencuar ministrja Hoxha, por çështja është nëse Bashkimi Evropian kujdeset për t'i bërë kosovarët të ndihen pjesë e Evropës dhe vlerave të saj, gjë që nuk duket.

Pastaj, ministrja Hoxha ka elaboruar çështjen e vizave. "Siç është konfirmuar nga Komisioni Evropian, Kosova ka përbushur të gjitha 95 kriteret nga udhërrëfyesi i ofruar në vitin 2012. Votimi në Parlamentin Evropian ishte shumë inkurajues për ne, duke shtyrë një hap përpara drejt qëllimit përfundimtar, i cili është lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës. Ndryshe nga vende të tjera nga rajoni, Kosova kishte 95 kriteret për t'i përbushur, numrin më të madh të kriterëve. Kosova ka bërë detyrat e shtëpisë duke përbushur të gjitha 95 kriteret që nuk ishin të lehta", ka deklaruar Hoxha. Rreth pesë muaj më parë, tha ministrja Hoxha, Komisioni



Evropian konfirmoi përbushjen e kriterëve nga Kosova dhe Kosova nuk ka rezultate, madje pa shpjegime të arsyeshme pse BE-ja nuk është në gjendje ta mbajë premtimin e saj dhe t'i respektojë rregullat dhe procedurat e veta. "Për 20 vjet ne besuam se institucionet e BE-së do të bëjnë gjithçka që mundën për ta mbajtur perspektivën evropiane të vendit tonë, si për të gjithë rajonin, dinamik,

konkret dhe të arritshëm, por kjo duket e pamundur në këtë fazë dhe mund të imagjinojmë se sa dëshpëruese është kjo për qytetarët tanë", ka thënë Hoxha, duke shtuar se si të besohet në procesin e zgjerimit dhe konsensusin e BE-së për zgjerimin me vendet e Ballkanit Perëndimor nëse BE-ja nuk mund të japë përgjigje teknike si liberalizimi i vizave. Ministrja Hoxha shprehu

brengën që Kosova është i vetmi vend i izoluar në Ballkanin Perëndimor, duke pasur vetëm MSA-në e nënshkruar, duke vënë në dukje gjasat e vogla që Kosova së shpejti të ketë një perspektivë evropiane. "Kosova po bën gjithçka për t'i përbushur standardet, parimet dhe vlerat e BE-së, megjithatë duket sikur po i afrohem BE-së, e ajo po ikën prej nesh", ka theksuar ministrja Hoxha.

Deputetët e PE-së kërkojnë heqjen e vizave për Kosovën



STRASBURG, 4 DHJETOR - Pak ditë para mbledhjes së Këshillit të Evropës, 22 anëtarë të Parlamentit Evropian nga grupe të ndryshme politike i kanë dërguar letër të hapur presidentit të Këshillit të Evropës Donald Tusk dhe përfaqësuesit permanent të Austrisë, Nikolaus Marschik, përmes së cilës kërkojnë heqjen

e vizave për Kosovën pa vonesë. Ata i bëjnë thirrje Këshillit të caktojë një votim për këtë çështje dhe të miratojnë regjimin pa viza sa më shpejt që është e mundur. "Kosova mbetet i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor qytetarët e të cilit ende kanë nevojë për viza që të udhëtojnë në Zonën Shengen. Kjo ka kri-

juar ndjenjën e izolimit që preketet e përditshme të qytetarëve të Kosovës. Ne tashmë kemi qenë dëshmitarë të rritjes së një gjenerate të re të përjashtuar nga pjesa tjetër e Evropës së bashkuar dhe prosperuese", thuhet në letër. Për më tepër, 22 eurodeputetët thonë se regjimi pa viza paraqet

një prej arritjeve më të prekshme dhe më konkrete të perspektivës evropiane të vendit. "Ne i bëjmë thirrje Këshillit që të caktojë një datë për votim në këtë çështje dhe të miratojë regjimin pa viza për Kosovën pa vonesë të mëtejme", thuhet në letër. Mbledhja e Këshillit të Evropës mbahet më 13-14 dhjetor.

Vuçiqi i kërkon ShBA-së ta shfrytëzojë ndikimin te Prishtina

BEOGRAD, 4 DHJETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka kërkuar të martën nga ambasadori amerikan në Beograd, Kyle Scott, që Shtetet e Bashkuara ta shfrytëzojnë ndikimin e tyre politik dhe ta paralajmërojnë Prishtinën se

me veprimet e saj po kërcënon paqen dhe stabilitetin në rajon. "Këmbëngulja e Prishtinës për tatimin e mallrave nga Serbia qendrore dhe, për më tepër, formimi i Ushtrisë së Kosovës, nxit shqetësim serioz në Serbi për të ardhmen e popullit serb

në Kosovë", ka thënë Vuçiqi, sipas një njoftimi të lëshuar nga Presidenca serbe. I njëjti ka cituar ambasadorin Scott të ketë thënë se me vendosjen e taksës Prishtina ka shkelur dispozitat e Marrëveshjes për Tregti të Lirë, CEFTA, dhe ka

kërcënuar të ardhmen e rajonit. Scott, po ashtu, ka kujtuar që sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, u ka bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që ta heqin taksën mbi mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.



Haradinaj: Taksa 100 për qind nuk hiqet

Qeveria e Kosovës nuk ka lëvizur nga vendimi për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Kështu ka deklaruar të martën kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë me gazetarë. Ai ka thënë se, pavarësisht prej tendencave, taksa nuk do të hiqet dhe, sipas Haradinajt, nëse dikush i ka borxhe Serbisë, t'ia lajë në mënyra të tjera. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se taksa ndaj produkteve serbe nuk ka të bëjë me liberalizimin e vizave

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se taksa prej 100 përqindësh, e vendosur ndaj produkteve serbe, nuk do të hiqet pavarësisht prej tendencave që ky vendim të mos jetë fuqplotë. "Nga momenti i marrjes së vendimit për taksën 100 për qind po e shohim se ka dëshira që ky vendim të mos jetë fuqplotë. Është e habitshme që të mos lejohet Kosova të konsolidohet. Kosova duhet të lejohet t'i kryejë punët e veta. Vendimi për taksën është legjitim, është 100 për qind dhe nuk ndryshon", ka deklaruar Haradinaj pas mbledhjes së Qeverisë në një konferencë me gazetarë.

Duke i komentuar reagimet e opozitës lidhur me vendosjen e takës, kryeministri Haradinaj ka thënë se Serbia nuk është duke i bërë dëm vetëm Qeverisë, por gjithë Kosovës. "I kemi parë disa deklarime të partive opozitare për taksën. Kemi dëgjuar deklarime edhe nga LDK-ja dhe këto deklarime nuk janë fort të qarta në atë që po vlerësojnë. Kemi dëgjuar edhe nga grupet e tjera politike. Vendimi për vendosjen e taksës nuk është i Qeverisë, është i Kosovës, sepse konsumatori dhe ekonomia jemi të gjithë ne. Dëmet që na bën Serbia nuk i shkojnë vetëm Qeverisë, por i vuan çdo qytetar

i vendit", është shprehur ai, duke shtuar se taksa nuk mund të hiqet duke krijuar situata të reja.

Madje, sipas Haradinajt, nëse dikush i ka borxhe Serbisë, le t'ia lajë në mënyra të tjera, meqë taksa nuk do të hiqet. "Vendimi për taksën nuk lëviz. E kanë gabim nëse mendojnë se, duke krijuar ndonjë situatë tjetër, ndryshon kjo. Nëse dikush i ka borxhe Serbisë, t'ia lajë ndryshe. Nëse ka mbetur ndonjë borxh diku, le të gjejnë mënyra të tjera për ta larë. Po ashtu, nuk mund ta heqim taksën duke krijuar insinuata të çfarëdo natyre. Vendosmëria e qytetarëve vetëm sa do të rritet nëse hetojnë tendenca që të mos lejojnë këtë vendim të mbetet në fuqi", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve serbe nuk është kundërshtuar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. "Ky vendim është ligjor. Vendimi i marrë është kompetencë e Qeverisë së Kosovës dhe është kushtetues dhe ligjor. Unë nuk kam parë kundërshtime nga presidenti dhe nuk kam marrë ndonjë mendim nga ai", ka theksuar Haradinaj.

Duke vlerësuar situatën pas vendosjes së taksës 100 për qind ndaj produkteve të prodhuara në Serbi dhe në Bosnjë e Hercegovinë, kryeministri Haradinaj ka thënë se gjendja në gjithë vendin është stabile dhe se ka një respektim të plotë



të taksës. Ai ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe nuk ka të bëjë asgjë me liberalizimin e vizave. Sipas Haradinajt, këto

janë dy pika krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra. Kryeministri ka ritheksuar se sa i përket liberalizimit të vizave

Kosova e ka kryer punën e vet, por tani çështja ka mbetur te Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian.

Qeveria i siguron pagë mujore 1 000 euro bashkëshortes së Ibrahim Rugovës

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka marrë vendim që bashkëshortes së ish-presidentit Ibrahim Rugova, Fana Rugova, t'i lejojë transferim i mjeteve financiare në vlerë prej 1 000 eurosh në muaj. Po me anë të këtij vendimi Rugova do ta ketë në shfrytëzim edhe një automjet dhe një drejtues të automjetit. Qeveria të martën ka miratuar edhe vendimin për lidhjen e marrëveshjes në

mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës. Kabineti qeveritar është informuar edhe për gjendjen e teatrove publike në qytetet e Kosovës, me ç'rast Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka bërë me dije se është duke punuar për hartimin e ligjit të ri për teatrot i cili do të sigurojë mbështetje të veprimtarisë

teatrore kudo në Kosovë dhe do të hapë mundësitë për themelimin e teatrove në të gjitha komunat që kanë potencial për ta zhvilluar veprimtarinë teatrore. Qeveria i ka propozuar Kuvendit të Kosovës që për kryetar të Bordit të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit të zgjedhet Bajram Zejnullahu, ndërsa për anëtar të ri në këtë bord është propozuar Hajzer Salihu.

KDI-ja u bënë thirrje partive të arrijnë konsensus politik për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - "Duke konsideruar se dialogu Kosovë - Serbi është proces i cili është konsideruar i paalternativë, proces për të cilin të gjitha partitë politike kanë shprehur mbështetjen e tyre, ndërtimi i konsensusit të gjerë politik është imperativ për ta përmbyllur procesin e dialogut dhe për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërkombëtare e cila respekton shtetin e Kosovës dhe sovranitetin e saj", është thënë në një komunikatë

të KDI-së.

KDI-ja e vlerëson pozitive nismën e ndërmarrë nga Partia Socialdemokrate (PS) për bashkërendimin e partive parlamentare nga pozita dhe opozita rreth ndërtimit të një qëndrimi unik shtetëror të Kosovës mbi fazën finale të procesit të dialogut.

KDI-ja vlerëson se draftrezoluta dhe projektligji i paraparë me këtë draftrezolutë janë dokumente të cilat mund të shërbejnë për përfshirjen e të



gjithë spektrit politik dhe për ndërtimin e konsensusit politik rreth dialogut me Serbinë, si një domosdoshmëri për ta

mbrojtur interesin e shtetit të Kosovës. "KDI-ja inkurajon partitë parlamentare në pozitë dhe opozitë të përfshihen në

diskutime konstruktive për avancimin e këtyre dokumenteve duke ofruar qëndrimet e tyre.

Partitë parlamentare duhet të bëjnë përpjekje serioze për nxjerrjen e një rezolute dhe ligji në marrëveshje me spektrin politik, duke respektuar kërkesën e qytetarëve të Republikës së Kosovës për bashkim të gjerë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi", është theksuar në komunikatën e KDI-së.

Flet për "Epokën e re", Vigan Qorrolli

Faji për mosliberalizim të



Njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, fajin për mosliberalizimin e vizave për Kosovën ua ka hedhur institucioneve të Kosovës dhe të BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se asnjëra palë në këtë proces nuk ka qenë korrekte. Qorrolli ka bërë me dije se institucionet vendore kanë përgjegjësi për mospërmbushjen e kriterit për luftimin e krimit dhe korrupsionit ndërsa, sipas tij, BE-ja është përgjegjëse për vendosjen e kriterëve jo të arsyeshme për Kosovën në këtë proces. Qorrolli ka shprehur skepticizëm se do të mund të bëhet diçka në këtë proces gjatë vitit 2019

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, për mosliberalizimin e vizave për Kosovën ka bërë përgjegjës të dyja palët, institucionet e Kosovës dhe Bashkimin Evropian (BE). Ai ka deklaruar se institucionet vendore janë fajtores sepse nuk kanë përmbushur kriterin e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, kurse BE-ja është fajtores për shkak se Kosovës në këtë proces i ka vendosur kushte joracionale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

deklaruar se pretendimet e Qeverisë, se i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, janë populiste. "Të dyja palët kanë pjesë të fajit për mosliberalizimin e vizave. Pa faj nuk mund të jetë as BE-ja, sepse situata nuk mund të jetë bardh e zi, ngaqë BE-ja është treguar shumë rigide me Kosovën në këtë proces, duke i vendosur kushte të cilat nuk i janë vendosur asnjë shteti tjetër" ka thënë Qorrolli.

Ai ka treguar edhe për përgjegjësinë e institucioneve të Kosovës në këtë proces. "Liberalizimi nuk u realizua për shkak të një kushti ende të paplotësuar nga Kosova. Ky

është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Me këtë BE-ja tregoi edhe një herë se është shumë e kujdesshme dhe se qytetarët e Kosovës nuk mund të udhëtojnë pa viza për shkak të elitave të tyre politike dhe për shkak të mosfunksionimit të rendit dhe ligjit në Kosovë", është shprehur Qorrolli.

Ai ka shprehur skepticizëm se do të mund të bëhet diçka në këtë drejtim gjatë vitit 2019.

Sipas Qorrollit, deri në vitin 2020 është shumë vështirë të ketë liberalizim të vizave për Kosovën. "Deklarimi i komisionarit Hahn ka qenë i qartë se para vitit 2020 nuk do të ketë

vizave është i dyanshëm



është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Me këtë BE-ja tregoi edhe një herë se është shumë e kujdesshme dhe se qytetarët e Kosovës nuk mund të udhëtojnë pa viza për shkak të elitave të tyre politike dhe për shkak të mosfunksionimit të rendit dhe ligjit në Kosovë. Në këtë fushë duhen fakte konkrete dhe nuk mjafton vetëm ngritja e aktakuzave nga ana e Prokurorisë së Kosovës, të cilat në shumicën e rasteve nuk i kanë fituar lëndët e tyre në gjykata. Në këtë proces kanë ndikuar edhe çështje të tjera, si dinamikat e brendshme të BE-së. Së pari ka qenë rreziku i refugjatëve nga Lindja e Mesme në BE, ku shtetet kryesore të BE-së janë të mbushura me refugjatë. Në këtë aspekt BE-ja është fokusuar se do të ketë fluks të madh të kosovarëve në BE me liberalizim të vizave. Së dyti, ka ndikuar çështja e Brexitit dhe, së treti, që është më rëndë, disa shtete që e kanë njohur Kosovën, si Franca, Gjermania dhe Holanda, janë skeptike për Kosovën dhe po presin që çfarë do të ndodhë me fatin e saj. Në këtë kohë është hapur çdo detaj i sovranitetit të Kosovës të cilin ato e kanë njohur. Tani po flitet për ndryshim kufijsh, kurse ato janë në dyshim në raport me Kosovën, duke ngritur dilemat e tyre në këtë aspekt.

"Epoka e re": Pas konfirmimit se nuk do të ketë liberalizim të vizave, Qeveria ka hequr çdo përgjegjësi nga vetja, duke thënë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet dhe se tani fajet për zvarritje të këtij procesi janë te Këshilli i BE-së?

Qorrolli: Këto janë deklarime populiste të zyrtarëve tanë shtetërorë, sepse BE-ja nuk funksionon me inercione të tilla, duke ofruar shkopin dhe karotën. BE-ja kërkon standarde. Standard që është plotësuar nga ana e Kosovës ka qenë vetëm demarkacioni. Kushti që lidhet me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe me aktgjykimet dënuese, ku gjykatat tona duhet t'i shpallin fajtorë njerëzit që janë të përfshirë në krim dhe korrupsion, nuk është plotësuar. Zyrtarët e BE-së e dinë se në Kosovë ka krim dhe korrupsion ngaqë në çdo Raport të Progresit në pesë vjetët e fundit thuhet se gjykatat tona janë të ndikuara nga politika. Kjo tregon se BE-ja është e kujdesshme dhe nuk do t'i liberalizojë vizat vetëm për shkak të kritereve teknike qysh kanë qenë dikur

pasaportat biometrike, pastaj edhe demarkacioni me Malin e Zi. Tash kërkon që Kosova të ketë edhe një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë, që nuk është kusht për viza, por që ekzistencën e Kosovës po e sheh shpeshherë me pikëpyetje për shkak të diskutimeve për kufij. Sovraniteti i Kosovës po cenohet dita-ditës sepse mosanëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, si Interpoli, mosliberalizimi i vizave dhe tërheqja e disa njohjeve për Kosovën, tregon se Kosovës po i rrezikohet ekzistenca e saj juridike.

"Epoka e re": Në bazë të kësaj, po i bie se për mosliberalizim të vizave faj kanë të dyja palët, institucionet tona për shkak të mosplotësimit të kushtit të fundit dhe BE-ja për shkak të dinamikës së saj të brendshme.

Qorrolli: Është e vërtetë se të dyja palët kanë pjesë të fajit për mosliberalizimin e vizave. Sigurisht se pa faj nuk mund të jetë as BE-ja, sepse situata nuk mund të jetë bardh e zi, ngaqë BE-ja është treguar shumë rigide me Kosovën në këtë proces, duke i vendosur kushte të cilat nuk i janë vendosur asnjë shteti tjetër. Natyrisht se dinamikat e brendshme të BE-së, mosnjohja e Kosovës nga pesë anëtarët e saj dhe skepticizmi i disa shteteve anëtare që e kanë njohur Kosovën, kanë ndikuar në këtë proces, mirëpo politikanët tanë nuk është dashur të bëjnë pazare me këtë premtim. Politikanët tanë prej vitit 2011 çdo gjashtë muaj kanë premtuar liberalizim të vizave. Kjo është një shuplakë e rëndë për politikanët tanë, duke u treguar atyre se liberalizimi i vizave nuk varet nga ta. Ata kanë folur për liberalizim të viza po sikur ë ishin duke folur për rregullimin e ndonjë kanalizimi në ndonjë fshat të Kosovës. Kështu që, kjo ka qenë e pafalshme dhe BE-ja i përcjell këto. Duket se kushtet kanë qenë të ndryshme, politikanët tanë kanë folur ndryshe në Bruksel e ndryshe në Prishtinë. Ata kanë qenë skajshmërisht të pasinqertë me popullin. Mendoj se deklarimi i komisionarit Hahn nuk ka qenë befasi sepse për mosliberalizimin e vizave ka treguar para disa muajve edhe kancelari austriak në Prishtinë, Sebastian Kurz, i cili ka theksuar se BE-ja është e ndarë për Kosovën. Fatkeqësisht, këtë ndasi nuk do ta vuajnë politikanët e Kosovës sepse ata dhe familjet e tyre do të vazhdojnë të udhëtojnë drejt BE-së. Mosliberalizimin e

vizave do ta vuajnë qytetarët e Kosovës të cilët, në mungesë të një perspektive më të mirë ekonomike në vend, do të vazhdojnë të mbesin më të izoluarit në Evropë edhe zyrtarisht.

"Epoka e re": Opozita ka reaguar fuqishëm ndaj mosliberalizimit të vizave, duke e bërë përgjegjëse Qeverinë. Madje ka thirrur seancë të jashtëzakonshme parlamentare. Si e keni parë këtë reagim?

Qorrolli: Faji nuk është vetëm i njërës palë. Faji është i shumanshëm për shkak se të gjithë kanë dështuar të ndihmojnë në krijimin e një ambienti të mirë politik dhe juridik në Kosovë. Si pozita ashtu edhe opozita i kanë fajet e veta në këtë proces sepse kanë dështuar të ndërtojnë një ambient në Republikën e Kosovës, ku së pari qytetarët të jenë të barabartë para ligjit. Këtu politikanët çdo ditë tregojnë se nuk janë të barabartë para ligjit, kurse qytetarët mbesin në hendeqe të thella të pabarazisë së tyre pranë organeve shtetërore. Pastaj të drejtat e qytetarëve shkelen çdo ditë nga institucionet e Kosovës dhe këto flasin për fajin e të dyja palëve. Tendencat e palëve për t'i marrë meritat nuk dua t'i komentoj, sepse nuk prodhojnë asnjë rezultat në raport me BE-në. Kjo e fundit ka treguar se është shumë e kujdesshme për vlerësimin e meritave të politikanëve tanë, sepse populizmi nuk është ndonjë vlerë shumë civilizuese. Populizmi është vetëm demagogji, dhe demagogjia zakonisht prodhon vetëm injorancë.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh dinamikën e brendshme në BE, skepticizmi është gjithnjë në rritje, kur kihet parasysh se zgjedhjet do të mbahen atje vitin e ardhshëm. Sa janë gjasat që të kemi liberalizim të vizave para vitit 2020?

Qorrolli: Deklarimi i komisionarit Hahn ka qenë i qartë, se para vitit 2020 nuk do të ketë liberalizim të vizave. Bile ai ka qenë i pasigurt nëse edhe në vitin 2020 do të mund të ndodhë kjo. Mendoj se para vitit 2020 nuk ka mundësi që asnjë presje t'i ndërrohet deklaratës së tij. Ai ka treguar se viti i ardhshëm në BE është vit zgjedhor, pastaj konsolidimi i institucioneve të reja të BE-së do të marrë disa muaj kohë. Kurse viti 2020 mund të prodhojë ndonjë mrekulli për këtë proces nëse deri atëherë mbetet ky entiteti i quajtur Republika e Kosovës.

liberalizim të vizave. Bile ai ka qenë i pasigurt nëse edhe në vitin 2020 do të mund të ndodhë kjo. Mendoj se para vitit 2020 nuk ka mundësi që asnjë presje t'i ndërrohet deklaratës së tij. Ai ka treguar se viti i ardhshëm në BE është vit zgjedhor, pastaj konsolidimi i institucioneve të reja të BE-së do të marrë disa muaj kohë", është shprehur Qorrolli.

"Epoka e re": Z. Qorrolli, komisionari Johannes Hahn tashmë ka konfirmuar në Prishtinë se nuk do të ketë liberalizim të vizave për Kosovën as këtë vit. Ju, në fakt, edhe më herët keni qenë pesimist se kjo do të

mund të ndodhte këtë vit. Pse ndodhi kështu?

Qorrolli: Besoj se kam qenë skeptik i arsyeshëm në këtë drejtim. Teoria e mosliberalizimit të vizave për këtë vit dhe për vitin 2019 po del e saktë, sepse kushtet të cilat i janë vendosur Kosovës qysh në fillim kanë qenë kushte joracionale dhe BE-ja është treguar më rigide karshi Kosovës. Kosova ka arritur t'i plotësojë kushtet në kohë rekorde, madje i është kërkuar edhe ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi, duke u bërë edhe disa pretime. Por, liberalizimi nuk u realizua për shkak të një kushti ende të paplotësuar nga Kosova. Ky

Koordinatori Hoti nis takimet me drejtorët e shkollave

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, të martën ka nisur takimet me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta si dhe atyre të mesme të larta në nivel vendi për shpалosjen e Programit Nacional për Rininë.

Takimin e parë Hoti e ka zhvilluar me drejtorët e shkollave Komunes së Vitisë, i shoqëruar

nga zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Azem Guri, si dhe drejtoresha Komunale e Arsimit, Fatbardha Emiri. "Programi Nacional për Rininë është hartuar për secilin nxënës të secilës shkollës, duke filluar nga niveli fillor, i mesëm i ulët dhe niveli i mesëm i lartë. Ky program parasheh përfshirjen e të gjithë nxënësve dhe studentëve në garë dhe pres që të gjithë ata të përfitojnë nga ky program", u shpreh koordina-

tori Hoti.

Drejtorët e shkollave e mirëpritën programin, duke thënë se do të punojnë për zbatim sa më të mirë të tij. Po ashtu, koordinatori Hoti u prit në takim edhe nga kryetari i Komunes së Vitisë, Sokol Haliti, i cili, pas nënshkrimit të memorandumit, ritheksoi gatishmërinë për bashkëpunim. Takimet me drejtorë të shkollave do të mbahen nëpër të gjitha komunat e Kosovës.



Haradinaj takon Surroin dhe Shllakun, flasin për dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim publicistin Veton Surroi si dhe drejtorin ekzekutiv të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur, Luan Shllaku. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj me Surroin dhe Shllakun kanë biseduar për procesin e dialogut Kosovë - Serbi si për dhe nevojën për bashkim të spektrit politik dhe të shoqërisë civile, në këtë fazë të zhvillimeve shumë të rëndësishme për vendin.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se faktori politik duhet ta ndërtojë konsensusin e brend-

shëm që të ndërtohet një platformë e cila e definojnë pozicionin e qartë të Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka folur edhe për taksën ndaj Serbisë, duke thënë se vendimi ishte përgjigje e politikës agresive dhe jo të drejtë ndaj shtetit të Kosovës dhe, si e tillë, do të mbetet në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga Serbia.

Kryeministri Haradinaj e ka mirëpritur iniciativën e dy njohësve të rrethanave politike në vend dhe rajon, për ta mbështetur procesin e dialogut final, si interes strategjik i Kosovës, për të cilin është e domosdoshme gjithëpërfshirje.



Ministri Bytyqi dhe përfaqësuesit e SBASHK-ut flasin për angazhimet e përbashkëta në arsim



PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, me bashkëpunëtorë, me të cilët ka biseduar rreth zhvillimeve në arsim, si dhe për angazhimet e përbashkëta që arsimit të bëhet prioritet në Kosovë. Ai ka falënderuar SBASHK-un për kontributin që ka dhënë dhe po jep në të gjitha proceset që po zhvillohen në arsim, me qëllim të përmirësimit në cilësisë. Ministri Bytyqi është shprehur i gatshëm për bashkëpunim dhe bashkërenditje të aktiviteteve

mes MASHT-it dhe SBASHK-ut në mënyrë që të shikohen mundësitë e përmirësimit të koeficienteve të mësimdhënësve përmes Ligjit për Pagat, pra që të punësuarit në sektorin e arsimit të kenë koeficient meritator. Bytyqi ka shtuar se është e rëndësishme që kërkesat të jenë të arsyeshme dhe të realizueshme konform mundësive buxhetore që ka vendi ynë. Në këtë takim, ministri Bytyqi dhe përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë biseduar edhe rreth zhvillimeve dhe procedurave nëpër të cilat po kalon Ligji për mësimdhënësit e viteve '90.

Tre profesorë nga Shqipëria mbajten ligjëratat publike në Universitetin "Ukshin Hoti"

PRIZREN, 4 DHJETOR (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, me ftesë të dekanatit të Fakultetit të Filologjisë, të martën kanë mbajtur ligjëratë tre profesorë nga Shqipëria. Prof. dr. Emil Lafa ka mbajtur ligjëratë me temën "Gjuha letrare shqipe si koine mbarëkombëtare", prof.

dr. Rami Memushaj ka mbajtur ligjëratë me temën "Naom Çomski dhe revolucioni i tij në gjuhësi", ndërsa prof. dr. Kujtim Kapllani ka mbajtur ligjëratë me temën "Vepra shkencore e Androkli Kostallarit".

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. dr. Shkëlqim Millaku, i ka

falënderuar profesorët nga Shqipëria për ligjëratat e mbajtura dhe ka theksuar se për studentët dhe mësimdhënësit e UPZ-së është nder i veçantë që të kenë mysafirë profesorë të këtij rangu. Dekani Millaku në fund u ka dhënë mirënjohje tre profesorëve nga Shqipëria.



Ambasadori i ri amerikan vazhdon takimet njoftuese me zyrtarët e Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli dhe Enver Hoxhaj kanë pritur të martën në takime të ndara ambasadorin e ri të ShBA-së, Philip Kosnett

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ambasadori i ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Philip Kosnett, është takuar të martën me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ministrin e Jashtëm, Behgjet Pacolli dhe zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj. Veseli dhe Kosnett kanë diskutuar për aktualitetin politik në vend dhe për bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Gjatë këtij takimi Veseli i ka thënë

Kosova do të ecë përkrah me ShBA-në në çdo hap", ka thënë Veseli pas takimit.

Edhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Philip Kosnett, nga i cili ka pranuar edhe kopjet e letrave kredenciale.

Zëvendëskryeministri i parë, Behgjet Pacolli, dhe ambasadori Kosnett kanë shkëmbyer pikëpamjet mbi mbarëvajtjen e zhvillimeve politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Ata kanë vënë në dukje në veçanti marrëdhënien



ambasadorit Kosnett se aleanca me ShBA-në është e shenjtë për Kosovën dhe popullin e saj. "Sot pata kënaqësinë t'i dëshiroj mirëseardhje ambasadorit të ri të ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është e shenjtë për popullin dhe institucionet e Kosovës. Me ambasadorin Kosnett, i cili është një diplomat me përvojë të madhe dhe që ka kontribuar për vendin tonë edhe më herët, biseduam për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova, por edhe për reformat që kemi ndërmarrë si shtet.

speciale dhe partneritetin strategjik në mes dy vendeve dhe dy popujve. Pacolli e ka quajtur jetike për Republikën e Kosovës vazhdimin e mbështetjes së mëtutjeshme dhe të bashkëpunimit të ngushtë e të afërt me ShBA-në.

Ndërsa ambasadori amerikan Philip Kosnett ka shprehur përkushtimin për të mbajtur bashkëpunimin të afërt në mes të Ambasadës së ShBA-së në Kosovë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Po ashtu, edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka pritur të martën në

takim njoftues ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj i ka uruar mirëseardhje ambasadorit Kosnett, ndërsa ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen, si

dhe rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën dhe shtetndërtimin e saj. Hoxhaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për thellimin e mëtejshëm të miqësisë dhe bashkëpunimit të

shkëlqyeshëm mes dy vendeve. Teksa kanë diskutuar në lidhje me përmbylljen e shtetndërtimit të Kosovës, dialogun Kosovë - Serbi, transformimin e FSK-së, si dhe sfidat rajonale, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka theksuar se përkrahja e shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë proces është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën. "Ambasadorit i shpreha mirënjohjen për rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe mbështetjen e ShBA-së për Kosovën. Diskutuam për përmbylljen e shtetndërtimit të Kosovës, dialogun me Serbinë, transformimin e FSK-së, si dhe për sfidat me të cilat përballet rajoni aktualisht. Shpreha përkushtimin për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyeshme në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj. Një ditë më parë ambasadori amerikan është takuar edhe me presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj.



Nuk mbahet seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga opozita

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ka dështuar të martën mbajtja e seancës së jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës lidhur me mospërfshirjen e vendit në agjendën e takimit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave. Kjo seancë ishte thirrur të martën nga dy partitë më të mëdha opozitare në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, të

cilat kanë vlerësuar se "dështimet e koalicionit qeverisës kulmuan me mosliberalizim të vizave".

Seanca nuk u mbajt për shkak të dyshimeve se është manipuluar me nënshkrimet e deputetëve për të thirrur këtë seancë. Pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, kreu i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se ka pasur manipulime me nënshkrimet e dy deputetëve. "Kur morëm

vendimmarrjen, në bazë të procedurave për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme, ne kemi marrë edhe dy shkresa. Një nga shkesat ka qenë shumë flagrante, pasi një nga deputetët ka treguar se nuk ka qenë i informuar për temën e seancës së jashtëzakonshme. Kemi lëndim të procedurave. Kërkesa e tanishme me këto manipulime e lëndon Kuvendin. Këtë nuk do ta lejoj", ka thënë Veseli.



Ministri Shala: Mosnjohja e Kosovës është pengesa më e madhe jotarifore në CEFTA

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka bërë hapjen e "Javës së CEFTA-s 2018" që po mbahet në Prishtinë nga 4 deri më 6 dhjetor. Ministri Shala ka falënderuar të gjitha institucionet, duke shtuar se do të përfitojmë nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të Organizatës Botërore të Tregtisë, Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë, GIZ-i, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, UNCTAD, Banka Botërore/ICF, përfaqësuesit e vendeve të CEFTA-së dhe të komunitetit të biznesit.

Shala ka vlerësuar se si objektive e përgjithshme e politikave ekonomike, Qeveria e Kosovës i kushton rëndësi të madhe krijimit dhe mbajtjes së një ekonomie liberale, duke respek-

tuar të gjitha rregullat e OBT-së. "Kosova njihet si një nga shtetet kandidate potenciale dhe i është dhënë perspektiva e BE-së nga Këshilli i BE-së. Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në duke rregulluar jo vetëm marrëdhëniet e tregtisë së lirë në mes të Kosovës dhe BE-së, por edhe duke vendosur parimet e asociimit mes BE-së dhe Kosovës. Kosova ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Transportit së bashku me BE-në dhe pesë shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ky është hap i rëndësishëm pozitiv për liberalizimin e tregjeve të transportit dhe për implementimin e direktivave të BE-së duke përfshirë edhe transportin rrugor në një mënyrë jodiskriminuese", ka

theksuar ministri Shala. Ministri ka thënë se Kosova është duke zbatuar CEFTA-n që nga viti 2006 dhe po ashtu detyrimet që kanë dalë nga kjo marrëveshje. Ai ka bërë me dije faktin se tri prej shtatë vendeve të CEFTA-s nuk e njohin Kosovën. "Kosova është duke zbatuar CEFTA-n që nga viti 2006. Kosova ka respektuar detyrimet e veta që rrjedhin nga zbatimi i CEFTA-s. Prandaj, ne kemi plotësisht të drejtë t'i gëzohemi suksesit të arritur deri më tani në CEFTA së bashku me vendet e tjera. Tri prej shtatë vendeve të CEFTA-s nuk e njohin Kosovën, dy prej tyre janë partnerë tregtarë të parë dhe të dytët më të mëdhenj rajonal në CEFTA. Kosova është një shtet që nuk ka dalje në det dhe ka një kufi të gjatë me Serbinë, si

ekonomia më e madhe në CEFTA, e cila nuk e njeh Kosovën. Përkundër këtij fakti, delegatët zyrtarë dhe shërbyesit publikë të të gjitha vendeve të CEFTA-s, përfshirë Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën, kanë treguar fleksibilitet dhe mirëkuptim të konsiderueshëm për njëri-tjetrin me qëllim që procesi i CEFTA-s të mbahet në rrugën e duhur. Kosova dhe vendet e CEFTA-s të cilat nuk e kanë njohur Kosovën kanë përdorur mjete kreative dhe inovative me akrobacione të artikuluar diplomatike si, p. sh., miratimi i Protokollit Shtesë 5 ose përdorimi i tabelave me emra personale në takime. Para jush, dua t'i falënderoj të gjithë këta profesionistë për guximin dhe fleksibilitetin e tyre", ka thënë

Shala. Sipas ministrit, janë disa çështje në CEFTA që shërbyesit publikë nuk mund t'i zgjedhin. "Për shembull, importet ose eksportet tona të cilat kalojnë përmes fqinj-it tonë i cili nuk e njeh vendin tonë, ndalen dhe atyre u kërkohet t'i dorëzojnë certifikatat nacionale të eksportit ose të importit të atij vendi për shkak se ata e konsiderojnë vendin tonë pjesë të tregut të tyre të brendshëm. Apo fakti që ai vend nuk i njeh tabelat e veturave apo nuk i pranon certifikatat e eksportit të vendit tonë për shkak se ato dokumente mbajnë emrin tonë kushtetues dhe flamurin. A mund këto probleme të zgjidhen nga shërbyesit publikë? Jo. A po shkelin këto probleme marrëveshjen? Po", ka thënë Shala.



OEK-u në përkrahje të organizatës "Down Syndrome Kosova"

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) më 18 dhjetor do të organizojë gala mbledhje në mbështetje të organizatës "Down Syndrome Kosova".

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, e ka quajtur të veçantë këtë konferencë. Ai ka sqaruar se mjetet që do të grumbullohen do të shkojnë për përkrahje të kësaj organizate. "Jemi në konferencë të veçantë

për ta paralajmëruar aktivitetin më 18 dhjetor. Është gala darkë. Me organizimin me 'Down Syndrome Kosova' do ta kemi një dedikim për komunitetin e kësaj organizate. Mjetet do të jenë dedikim për shërbimet e kësaj organizate. Do të ketë të hyra për darkën, por edhe do të ketë të hyra nga ata që duan të japin", ka thënë Berat Rukiqi.

Drejtoresha e organizatës "Down

Syndrome Kosova", Sebahate Beqiri, ka falënderuar OEK-un për organizimin e kësaj ngjarje, duke shtuar se me këtë aktivitet do të kenë mundësi të njoftohen me bizneset në mënyrë që të mund t'i prezantojnë edhe disa prej produkteve të kësaj organizate. Në emër të kësaj shoqate ajo shprehu mirënjohje për Odën Ekonomike si institucion që ka kontributin e tyre për shoqëritë.



BERZh-i ndan 17.6 milionë euro për hekurudhën Fushë-Kosovë - Mitrovicë



17.6 milionë euro do të kushtojë faza e dytë e projektit për rehabilitimin e linjës 10 hekurudhore, segmenti Fushë-Kosovë - Mitrovicë

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministri i Financave, Bedri Hamza, shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Nataliya Apostolova, si dhe drejtoresha e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për sektorin e Transportit, Sue Barrett, kanë nënshkruar marrëveshjen grant për fazën 2 për projektin për rehabilitimin e linjës 10 hekurudhore.

17.6 milionë euro do të kushtojë faza e dytë e projektit për rehabilitimin e linjës 10 hekurudhore, segmenti Fushë-Kosovë - Mitrovicë.

Shefja e Zyrës e BE-së dhe përfaqësuesja speciale e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se BE-ja do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën për financimin e projekteve të ndryshme që e ndihmojnë zhvillimin ekonomik. "Jemi në pjesën e dytë të financimit të sigurt. Do

të rehabilitohen rreth 100 kilometra hekurudhë dhe do të bëhet ngritja e pesë stacioneve në seksionin në kufi me Maqedoninë dhe Fushë-Kosovë Mitrovicë", u shpreh ajo.

Apostolova ka thënë se nënshkrimi i marrëveshjes për pjesën e parë ka qenë e arritur e rëndësishme për rehabilitimin e rrjetit të hekurudhave që lidh pjesën e lindjes me pjesën tjetër evropiane. "Rehabilitimi i këtij seksioni do të fillojë në muajt në vijim. BE-ja ka siguruar 17.6 milionë euro grant. Dua ta falënderoj BERZh-in për bashkëpunimin për investimet në Ballkanin Perëndimor", ka deklaruar Apostolova, duke shtuar se ky projekt do ta përmirësojë sigurinë dhe efikasitetin

e sigurt hekurudhor për gjysmën e popullatës të Kosovës, si dhe do të krijojë 160 vende të punës gjatë ndërtimit dhe veprimtarisë së përmbytjes.

Drejtoresha e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për sektorin e Transportit, Sue Barrett, ka thënë se është e kënaqur që me rezultatet e këtij projekti po thellojnë bashkëpunimin me Ballkanin Perëndimor. "BE-në dua ta falënderoj për bashkëpunimin dhe për bashkëfinansim të projekteve. Ne jemi të zotuar të vazhdojmë të investojmë në transportin e Kosovës dhe t'i mundësojmë ndërlidhjet e Kosovës me BE-në. Marrëveshja që nënshkruam sot do t'i plotësoj huat nga BERZh-i

rreth 80 milionë euro dhe do ta lidhë Maqedoninë në jug dhe Serbinë në veri", ka thënë Barrett. Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se Kosova ka marrë një lajm të mirë pasi nga taksapaguesit evropianë ka marrë 17.6 milionë euro falas në mënyrë që të ndihmohet rehabilitimi i linjave hekurudhore. "Marrëveshja që nënshkruam është kontribut financiar pa kthim, para falas që ka vlerën 17.6 milionë euro dhe do të përdoren për rehabilitimin e linjës hekurudhore prej Fushë-Kosovës deri në Mitrovicë", ka thënë Hamza, duke shtuar se shumë shpejt presin t'i fillojë negociatat e tjera për segmentin prej Mitrovicës deri te kufiri i Kosovës.

Prezantohen rezultatet e projektit 'Qasja biheavioriste në ngritjen e përmbytjes tatimore'

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ekspertët nga Banka Botërore kanë prezantuar rezultatet nga projekti "Qasja biheavioriste në ngritjen e përmbytjes tatimore". Projekti në fjalë është tërësisht i ri dhe unik jo vetëm në Kosovë, por edhe në regjion. Rezultat e projektit tregojnë se institucionalizimi i qasjes biheavioriste në mbledhjen e tatimeve i mundëson Kosovës të krijojë (zhvillojë) ndërhyrje të cilat mund të jenë efektive, me kosto të vogël dhe kërkesa të vogla për resurse njerëzore dhe administrative.

Projekti "Qasja biheavioriste në ngritjen e përmbytjes tatimore", i realizuar gjatë vitit 2018, si bashkëpunim i Bankës Botërore dhe GIZ - Qeveria Gjermane, ofron një perspektivë që tregon se sa vendimmarrja mund të ndikohet nga kombinimi i faktorëve personalë, të mjedisit dhe shoqëror. Synim i këtij eksperimenti me dy grupe të tatimpaguesve, në Tatimin e të Ardhurave Personale dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ishte ngritja e përmbytjes tatimore. Po ashtu, administrata tatimore mbetet mirënjohës për

mbështetjen e vazhdueshme për ATK-në dhe realizimin e këtij aktiviteti - eksperimenti me shumë interes për reformat e ardhshme të ATK-së, të vendosura edhe në planin e reformave për periudhën 2019-2021.

ATK-ja vazhdimisht është duke zhvilluar aktivitete për ta ngritur nivelin e përmbytjes së obligimeve tatimore, përfshirë transparencën në shërbimet ndaj tatimpaguesve, të cilët do ta kenë më të lehtë informimin dhe kryerjen e obligimeve në mënyrë vullnetare.



Përurohët stacioni i autobusëve në Skenderaj

SKENDERAJ, 4 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, të martën ka marrë pjesë në përuhimin e pikës së parë të stacionit model të autobusëve në këtë komunë. Jashari ka thënë se ky stacion është me kushte shumë të përshtatshme, ulëse dhe WC publike, për udhëtarët që presin linjat e autobusëve, afër Çerdhes së Fëmijëve "Nëna Zahide". "Kjo pikë stacioni, që nuk do të jetë e vetme në Skenderaj, është

dhuratë nga firma 'Shkumbini - AG' nga Deçani, me pronar Nexhat Ramë Mulajn, menaxher Sevda Radogoshin dhe drejtor Samir Osmanajn, të cilët i falënderoj në emër të qytetarëve të Skenderajt për këtë të mirë që na bënë. Do të shtojmë edhe pika të tjera të tilla nëpër vende të ndryshme brenda territorit të komunës sonë, aty ku ka numër më të madh të udhëtarëve që presin", ka thënë kryetari Jashari.



Bahtiri kërkon nga Qeveria ta dërgojë në Kuvend propozimin për bashkimin e Mitrovicës

MITROVICË, 4 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se bashkimi i Mitrovicës do të ndodhë pavarësisht prej kundërshtimeve. "Bashkimi i Mitrovicës do të ndodhë pavarësisht prej kundërshtimeve. Nuk ka rrugë tjetër. Unë kam kërkuar bashkimin e qytetit të Mitrovicës në një komunë të vetme, ashtu siç ka qenë gjithmonë, kërkesë e cila është mbështetur nga të gjitha partitë politike në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës. Tash Qeveria duhet të bëjë veprime konkrete për ndryshimin e ligjit

përkatës, që do ta bënte Mitrovicën me një komunë të vetme", ka shkruar Bahtiri në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se qarqe të caktuara politike në Kosovë janë duke e kundërshtuar nismën për bashkimin e Mitrovicës. "Qarqe të caktuara politike po e kundërshtojnë këtë nismë, por që nuk po i kundërshtojnë veprimet për ndarjen e Kosovës të kryetarëve të komunave me shumicë serbe në veri. Pra, si është e mundur që unë nuk kam drejt të punoj për bashkimin e qytetit, i cili gjithmonë ka qenë një dhe i vetëm, e

dikush tjetër prej kolegëve të mi serbë paska drejt ta kërkojë ndarjen e Kosovës. Unë e di saktë çka dua dhe jam thellësisht i bindur se bashkimi do të ndodhë. Mirëpo, më vjen keq që institucionet qendrore nuk e kanë këtë informacion, e që do të duhej ta kishin", ka shkruar Bahtiri. Ai i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të veprojë sa më shpejt dhe ta dërgojë në Kuvend propozimin për ndryshimin e ligjit që do ta bashkonte Mitrovicën në një komunë, sepse nuk ka rrugë tjetër përveç bashkimit të qytetit.



Sesion shkencor kushtuar 70-vjetorit të lindjes së prof. dr. Tafil Kelmendit

MALISHEVË, 4 DHJETOR (ER) - Sesion shkencor kushtuar 70-vjetorit të lindjes së prof. dr. Tafil Kelmendit, jetës dhe veprimtarisë krijuese, u organizua nga Shoqata për Kulturë dhe Letërsi "Tafil Kelmendi", e mbështetur nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Republikës së Kosovës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e

Komunës së Malishevës. Nga MKRS-ja një fjalë rasti drejtuar sesionit shkencor e mbajti zëvendësministri i kësaj ministrie, Rexhep Mazreku. "Kjo ditë është më shumë peshë për Malishevën, Kosovën, dijetarët e gjuhësisë, mësimdhënësit, studentët, kolegët e Tafilit dhe familjen, në veçanti për hulumtuesit e rinj të fushës së

gjuhësisë, veprës ende në dorëshkrim të Tafilit Kelmendit, që t'i qasen për studim dhe botim dhe t'u shërbejë studentëve në të ardhmen", ka thënë Mazreku. Kurse kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se vepra e Tafilit Kelmendit bëri që sot të jemi së bashku dijetarë nga Tirana dhe Prishtina.

Nisin punimet për rregullimin e rrugës me kubëza në fshatin Pastasellë

RAHOVEC, 4 DHJETOR (ER) - Kanë nisur punimet për rregullimin e një rruge me kubëza në fshatin Pastasellë të Komunës së Rahovecit. Në ceremoninë e nisjes së punimeve i pranishëm ishte kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë dhe banorë të këtij fshati. "Sot e fillova ditën me inaugurimin e punimeve për shtruarjen e rrugës me kubëza në fshatin Pastasellë, e

cila ka qenë në gjendje shumë të keqe. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për banorët e këtij fshati", është shprehur Latifi. Ndërsa banorët e fshatit Pastasellë e kanë falënderuar kryetarin për vizitën dhe për inaugurimin e punimeve për kubëzimin e rrugës, duke thënë se rruga ka qenë në gjendje të keqe dhe se me kubëzimin e saj do t'u lehtësohet lëvizja.



Transformimi i FSK-së në ushtri do t'i kontribuojë paqes në rajon



Ramadan AVDIU

Transformimi i Forcës së Sigurisë në Ushtri të Kosovës do të jetë hapi vendimtar për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt në Gadishullin Ballkanik dhe Evropën Juglindore historikisht të trazuar.

Ushtria e Kosovës do t'i kontribuojë paqes dhe prosperitetit të gjithë regjionit sepse përfundimisht do ta shuajë ëndrrën serbe për të përsëritur edhe ndonjë valë të re të gjenocidit mbi popullin shqiptar në Kosovë dhe Maqedoni.

Shqiptarët ende nuk kanë arritur t'i shpaleshin para botës tmerret, gjenocidin dhe dëmet e shkaktuara nga serbët. Që nga hartimi i platformës serbe për

zgjerim, të quajtur Naçertania më 1844, e deri në përfundim të luftës çlirimtare të udhëhequr nga UÇK-ja më 1999, Serbia në mënyrë sistematike ka ushtruar gjenocid mbi popullin shqiptar. Pra, për më shumë se 150 vjet raportet shqiptaro-serbe karakterizohen me konflikte dhe luftëra në të cilat popullata shqiptare ka qenë viktimë e gjenocidit të paparë. Nga ajo kohë deri tash mund të përmendim të paktën pesë periudha historike kur është ushtruar gjenocid mbi shqiptarët.

1. Pas marrëveshjes së Shën Stefanit më 1876-1878, pason vala e parë e gjenocidit serb mbi shqiptarët, ku nga serbët u vranë mizorisht më shumë 300 000 shqiptarë në Sanxhakun e Vranjës, të Nishit, të Prokuplës, të Leskovcit dhe në mbi 740 vendbanime të populluara me shqiptarë. Për dy vjet tërë popullata shqiptare në Toplicë është vrarë ose dëbuar nga vatrat e veta.

2. Në luftërat ballkanike 1912 pason vala e dytë e gjenocidit

serb mbi shqiptarët. Në trevat shqiptare në Kumanovë, Shkup, Ferizaj, Prishtinë, Prizren dhe në pjesë të tjera të Kosovës, Maqedonisë dhe të Shqipërisë, janë vrarë me qindra mijë shqiptarë të pambrorur nga ushtria serbe. Para botës, propaganda serbe, civilët e vrarë shqiptarë, është përpjekur t'i paraqesë pjesëtarë të ushtrive të perandorisë turke.

3. Në mes të dy luftërave botërore pason vala e tretë e gjenocidit serb mbi shqiptarët dhe në këtë periudhë janë vrarë e djegur e masakruar shumë vendbanime shqiptare, kurse një pjesë e madhe e popullatës shqiptare nga Kosova e Maqedonia është dëbuar në Turqi.

4. Pas Luftës së Dytë Botërore pason vala e katërt e gjenocidit serb mbi shqiptarët, ku vetëm në Gjilan, Ferizaj dhe Drenicë do të vriten mbi 50 mijë shqiptarë nga ushtritë serbe.

5. Nga viti 1981 e deri më 1999 do të pasojë vala e pestë e

gjenocidit serb mbi shqiptarët. Për të gjitha aktet gjenocidare që Serbia ka ushtruar mbi shqiptarët, përveç në vitin 1999, asnjëherë nuk është ndëshkuar. Përkundrazi. Pas gjenocidit të parë dhe të dytë mbi shqiptarët, në vend të ndëshkimit, Serbia është shpërblyer, duke iu njohur pushtimi i tokave shqiptare në Kongresin e Berlinit më 1878 dhe në Konferencën e Londrës më 1913, dhe në Konferencën në Versajë më 1919-1920.

Pikërisht kjo qasje e mosndëshkimit e ka trimëruar Serbinë, pastaj në valët e tjera deri më 1999 Serbia ka aplikuar metoda fashiste për t'i eliminuar shqiptarët si të tillë nga trojet e veta dhe në vazhdimësi kurdo që iu ka dhënë rasti ka përsëritur krimin e gjenocidit mbi shqiptarët.

Mbetet që këto periudha të tmerrshme historike për popullin shqiptar të ndriçohen nga shkencëtarët dhe të dëshmohet gjenocidi sistematik serb kundër shqiptarëve.

Serbia nga viti 1999 është duke

ëndërruar që sërish do t'i krijojnë rrethanat e përshtatshme për të ushtruar një valë të re gjenocidi mbi shqiptarët.

Paralajmërimi e krijimit të ushtrisë së Kosovës ia shuan këtë ëndërr dhe, mbase, ndikon edhe në vetëdijesimin e saj që gradualisht t'i kthehet vetvetes dhe problemeve të saj, duke i zvetënuar idetë shoviniste e hegjemoniste me të cilat është udhëhequr për më shumë se një shekull e gjysmë.

Vetëdijesimi i Serbisë, pastrimi i saj nga idetë fashiste e hegjemoniste në regjion, është kushti themelor për paqe të qëndrueshme dhe perspektivë për mbarë regjionin.

Serbia është frenuesja kryesore e proceseve përparimtare në regjion. Ajo duhet të gjykohej për krimet e gjenocidit ndaj shqiptarëve. Gjykimi i saj ndikon edhe në këndelljen e saj, andaj bërija që të heqë dorë nga ambiciet e saj të çmendura do ta fusë përfundimisht në rrjedha të zhvillimit të një shteti normal.

Bacë Ademi Demaçi, kush ta urojë 28 Nëntorin?



**Salihe SALIHU, PhD
dhe veprimtare**

Dita e Flamurit Kombëtar është ditë e shenjtë për popullin shqiptar, në veçanti kjo ditë është një ditë me specifike për ne shqiptarët e Kosovës sepse ishte pikërisht ky flamur që na frymëzoi për të luftuar për ta mbrojtur e për ta ruajtur identitetin tonë kombëtar. Ishte flamur kuq e zi, me shqiponjë dykrenare, me të cilën u betuan atdhetarë të gjeneratave të njëpasnjëshme që luftuan për ta ruajtur qenien shqiptare. Me flamur kombëtar të ruajtur në gji shqiptarët brez pas brezi rezistuan çfarëdo politike joshëse që mund ta servonte pushtuesi për të na asimiluar dhe për të na sllavëzuar.

Kjo rezistencë, ky frymëzim, u bartë me guxim të pashoqë e me heroizëm dhe krenari nga disa pishtarë lirie të spikatur, siç ishte bacë Adem Demaçi. Ishte pikërisht bacë Adem Demaçi që u shkrijë si qiri dhe nuk u pajtua kurrë me asnjë

demagogë që largohet prej rrugës së sakrificës për t'i ruajtur vlerat dhe identitetin kombëtar, gjuhën e flamurin e shenjtë si element të patjetërsueshme të identitetit shqiptar. E tash, pash besën, pa më thuj bacë, ai iu kujtua ndokujt që të urojnë për këtë ditë? A të erdhi ndonjë person me buqetë lule që të të thotë: të jem mirënjohës bacë për gjithë sakrificën që bërë për këtë vend, popull dhe flamur. E di bacë që ti do të përgjigjesh që: gjithçka çka unë veprova, ishte obligim ndaj atdheut. Kjo është përgjigje e natyrshme që do ta dëgjonim nga Ju - si njeri i sakrificës.

Por, athua a e meriton të harroshesh kaq shpejt. Ndoshta gjithçka u dashka të bëhet shpejt pas vdekjes tënde. Të varrosim shpejt e të mos ftojmë e presim as korin diplomatik në shtetet nga të cilat mund të pritej prania e tyre gjatë ceremonisë së varrimit. Gjithçka u përmbyllë me shpejtësi. E tani, një pullë postale me figurën tënde, bacë, u paraqit në këtë 28 nëntor, por edhe ky nderim u përcoll në heshtje pa ndonjë afirmimet apo pa bujë mediatike.

Mediat ishin vërsulur gjithandej te heronjtë e te figurat të tjera, por jo te varri i bacë Ademit Demaçi. Sigurisht se



edhe të tjerët janë meritore dhe pa fije dyshimi që duhej edhe ata të nderohen, por jo para se të nderohet Adem Demaçi. Me këtë gjykim, befas një imazh hipotetik, m'u vërsul nëpër kokë - po sikur të mund të fliste komandat Adem Jashari kur u bëheshin nderime nga shumë personalitete në këtë ditë. Ai

sigurisht se do të lutej që së pari ta nderojmë bacë Adem Demaçin për këtë 28 nëntor. Të paktën Adem Jashari do të ishte mirënjohës sepse edhe ai ishte frymëzuar nga shëmbëlltyra e bacë Adem Demaçit.

Në fund fare, uroj që ky imazh hipotetik i lartpërmendur të shërbejë për reflektim në të

ardhmen - gjatë festimeve të 28 nëntorit. Vlerat e kombit, si bacë Adem Demaçi, nuk bënë t'i lëmë në harresë. Veprimet mosmirënjohëse janë atentat i së nesërme. Prandaj, na falë bacë Ademi për këtë radhë, se herë tjetër, të paktën, do të na kujtohesh që të ta urojmë 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit.

Pompeo vë në pikëpyetje rendin e tanishëm botëror



BRUKSEL, 4 DHJETOR - Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo vuri në pikëpyetje rendin e tanishëm botëror dhe tha se Shtetet e Bashkuara po marrin veprime konkrete për reformimin e institucioneve globale. Këto komente Pompeo i bëri në takimin e zhvilluar në Fondin Gjerman Marshall në Bruksel. Sekretari amerikan i Shtetit tha se Kina, Irani, Rusia dhe vende të tjera kanë shkelur traktate dhe marrëveshje shumëpalëshe, duke shtuar se ShBA-ja nuk ka për t'i pranuar

më këto shkelje. Ai fajësoi mungesën e udhëheqjes amerikane dhe evropiane në çështjet botërore gjatë 30 vjetëve të fundit.

Pompeo tha gjithashtu se Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Bashkimi Afrikan dhe Banka Botërore kanë nevojë për reforma. Ai la të kuptohet se Organizata Botërore e Tregtisë nuk është duke ndjekur rregullat e veta në rastin e Kinës. "Rusia po shkel traktatet kryesore të kontrollit të armëve, ndërsa Irani nuk po përfill rezolutat e

Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kina, Irani dhe Rusia i kanë mohuar këto akuza, të ngritura shpesh nga ShBA-ja. Kur shkelen traktatet, shkelësit e tyre duhen konfrontuar dhe traktatet duhen rregulluar, ose prej tyre duhet hequr dorë", tha Pompeo.

Aleatë dhe kundërshtarë e kanë akuzuar administratën Trump për sulme ndaj rendit botëror, përmes qëndrimeve të njëanshme ndaj disa çështjeve, si marrëveshja e Parisit për klimën dhe marrëveshja bërthamore me Iranin.

Hetimi mbi ndërhyrjen ruse në zgjedhjet amerikane

Avokati Cohen pranoi fajësinë se gjatë dëshmime në Kongres kishte gënjyer në interes të presidentit Trump, duke mos u treguar të vërtetën ligjvënësve për një projekt ndërtimi në Rusi, ndërkohë që Trumpi kandidonte për president

WASHINGTON, 4 DHJETOR - Hetimi për Rusinë i drejtuar nga prokurori i posaçëm Robert Mueller duket se po hyn në një fazë të re pas pranimit të fajësisë javën e kaluar nga Michael Cohen, i cili prej kohësh ka qenë avokati personal i presidentit Donald Trump. Analistët po debatojnë tani nëse hetimi për Rusinë është duke shkuar drejt përfundimit dhe nëse po, cilat mund të ishin rrjedhojat për presidentin dhe për vendin. Në një seri komentesh në "Twitter", presidenti Trump sulmoi ashpër prokurorin e posaçëm Robert Mueller dhe ish-avokatin e tij personal Michael Cohen. Javën e kaluar Cohen pranoi fajësinë se gjatë dëshmime në Kongres kishte gënjyer në interes të presidentit Trump, duke mos u treguar të vërtetën ligjvënësve për një projekt ndërtimi në Rusi, ndërkohë që Trumpi kandidonte për president. Presidenti tha se nuk është i shqetësuar për ato që ish-

avokati i tij mund t'u tregojë hetuesve. "Aspak nuk jam i shqetësuar", tha ai.

Pranimi i fajësisë nga Cohen e çon më tej hetimin, për të parë lidhjet e mundshme ndërmjet Trumpit dhe Rusisë, thotë senatori demokrat i Virxhinias, Mark Warner. "Ky është një tjetër shembull se si njëri prej aleatëve më të afërt të presidentit gënjen rreth lidhjeve të tyre me Rusinë dhe me rusët", tha ai.

Senatori Warner dhe senatori Republikan i Karolinës së Veriut Richard Burr kryesojnë hetimin e një komisioni të Senatit rreth ndërhyrjes ruse në zgjedhjet e vitit 2016. "Mandati ynë është që në fund të kësaj t'i afrohem sa më shumë të vërtetës. Dhe këtë nuk mund ta bëjmë me hamendje, por me fakte", thotë senatori Burr.

Zhvillimet e fundit lënë të kuptohet se hetimi për Rusinë i drejtuar nga prokurori i posaçëm Robert Mueller ndoshta po i afrohet pikës kul-



more, thotë analisti Ric Simmons. "Pres që të shohim një lloj përfundimi të hetimit brenda disa muajve të ardhshëm. Megjithatë, Mueller nuk ka një afat kohor që caktuar me ligj dhe as është i detyruar të na thotë, prandaj nuk mund ta dimë me siguri", thotë Simmons.

Pranimi i fajësisë nga Cohen dhe paditë e tjera të ngritura në këtë hetim nga prokurori i posaçëm e kanë forcuar besueshmërinë e

hetimit për Rusinë, edhe pse presidenti vazhdon ta quajë atë një gjueti shtrigash. "Mendoj se kjo ia shton më shumë legjitimitetin hetimit dhe se në fakt shohim shumë tym në këtë aspekt të veçantë që meriton të hetohet. Mendoj se kjo hedh poshtë pretendimet se ky hetim është një trillim apo një gjueti shtrigash", thotë eksperti Doug Spencer.

Mueller nuk ka thënë se në ç'fazë është hetimi, por 2019-a mund të

jetë një vit i rëndësishëm, thotë analisti Simmons. "Ai ka bërë shumë punë me dëshmitarë të tjerë që kanë pranuar të tregojnë dhe ka muaj që punon me ta. Prandaj pres të shohim që kjo të përfundojë brenda disa muajve të ardhshëm", thotë ai.

Hetimi mund të arrijë një pikë kulmore tani që demokratët do të marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe ndërsa presidenti përgatitet të rikandidojë për rizgjedhje në vitin 2020.

Franca pezullon taksën e karburanteve që nxiti protestat

PARIS, 4 DHJETOR - Kryeministri francez Edouard Philippe thotë se taksë e planifikuar e karburantit është pezulluar, pas disa javë protestash të mëdha nga qytetarë të veshur me xhaketa të verdha të sigurisë. Në një fjalim televiziv, Philippe tha se asnjë taksë nuk meriton të rrezikojë unitetin e kombit. "Së bashku me presidentin e Republikës, anëtarët e parlamentit, e dëgjojmë këtë zemërim dhe e vlerësojmë realitetin, forcën dhe seriozitetin e situatës. Është zemërimi i francezëve që puno-

jnë, që punojnë shumë dhe që e kanë të vështirë të përballojnë jetesën", tha ai.

Tërheqja vjen pas protestave kundër taksës së karburantit që shkaktoi trazira në Paris, me njerëzit që plaçkitën dyqanet, dogjën makina dhe shkruan me grafiti mesazhet e tyre në Harkun e Triumfit dhe Varrin e ushtarit të panjohur.

Kryeministri francez Edouard Philippe njoftoi të martën një pezullim të rritjes së taksave të karburantit, një kthesë e madhe në përpjekje për të qetësuar lëvizjen e protestës që ka



radikalizuar dhe e ka çuar Parisin në kaos.

Pas trazirave në kryeqytet, më të rëndat në dekada, Philippe e tërhoqi mbështetjen për rritjen e planifikuar të taksës, e cila ishte vendosur të hynte në fuqi në janar dhe që tani po shtyhet deri në verë. "Jam i bindur se nëse shteti duhet të mbetet i fortë dhe i vendosur, së pari ai duhet të garantojë paqen publike. Është një domosdoshmëri për të qeverisur Francën, por asnjë taksë nuk meriton të rrezikojë unitetin e kombit", tha kryeministri Philippe.

(Kushtuar idealit të heroit që sakrifikon jetën për liri)

DËSHMORI I KOMBIT AGIM BAJRAMI DHE LIRIA

Prof. dr. Emin KABASHI
Këshilltar shkencor
Instituti Albanologjik i
Prishtinës

Kur atdheu thërret për liri, gjithmonë i bëhen krahë ata dhe ato, të cilëve jeta ua ka mësuar shkollën e madhe - Atdheu mbi të gjitha. Një nga ata luftëtarë të lirisë, që ishte në radhët e para të thirrjes së atdheut, ishte dëshmorin i kombit, Agim Bajrami. Idealin e luftës për liri dhe shkollën e madhe të jetës, se atdheu është mbi të gjitha, e kishte mësuar nga historia e familjes, nga historia e gjeneratave para tij, nga historia e tokave të pushtuara shqiptare, andaj as nuk i kishte ardhur nga qielli, as nuk i kishte mbirë nga toka.

Sepse, ndonjëherë, kur flasim dhe shkruajmë për ata që janë bërë shenja të lirisë së atdheut, kur flasim për ata që me rënien e tyre, kanë hapur procesin e madh kombëtar, krijohet bindja, pa dashur, thuajse çdo gjë e kanë gjetur të gatshme, thuajse rrugës për të dhënë jetën për liri, kanë mësuar vetëm të ecin drejt saj, thuajse e kanë pasur të parathënë, që me rënien e tyre, do të bëhen pjesë e kujtesës sonë kombëtare.

Hyrje

Kush ishte Agim Bajrami? Cila ishte lufta e Agim Bajramit? Dëshmorit të Kombit, Agim Bajramit, nga Stagova e Kaçanikut legjendar, rrugën për ardhjen e lirisë ia kishte mësuar jo vetëm historia e familjes, dhe e familjeve të tjera atdhetare të Kaçanikut, por edhe heroizmi shekullor i shqiptarëve, që nga Arbëria e Skënderbeut e deri te qëndresa heroike e Idriz Seferit. Por, përkundër gjithë atyre luftërave për liri, përkundër gjithë asaj sakrifice shekullore, atdheu i dëshmorit Agim Bajrami ishte i copëtuar dhe ishte i pushtuar. Prandaj, duhej lufta e tij, që edhe në këtë pjesë të atdheut të vinte liria, prandaj duhej edhe rënia e tij, që të bëhej realitet çlirimi i kësaj pjese të gjeografisë së Atdheut, e të bëhej sërish mësim jetësor i të gjithë brezave që do të vijnë, se atdheu është mbi të gjitha.

Dëshmorin i Kombit, Agim Bajrami, që nxënës i shkollës së mesme kishte bërë hapat e parë në luftë kundër pushtuesit. Që nga ato vite të rinisë së hershme, ai do të përballej, jo vetëm me padrejtësitë historike që ia kishin shkaktuar të tjerët atd-

heut të tij, prandaj edhe Kaçanikut të tij, por do të përballej edhe me torturat fizike e shpirtërore, që ishin mjete dhune të pushtuesit dhe veglave të tij për ta mbajtur sa më gjatë këtë pjesë të popullit shqiptar në robëri.

Dëshmorin i Kombit, Agim Bajrami dhe ideali i luftës për liri

Çka të thuhet më tepër për rrugën jetësore të Agim Bajramit, nga ato që ka thënë bashkëshortja dhe bashkëluftëtarja e tij, zonja e nderuar Zaria Bajrami. Çka të thuhet për rrugën e veprimtarisë së tij, edhe ilegale, edhe luftarake, pas asaj që kanë shkruar për të, bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e tij.

Megjithatë, në këtë vit, të përvjetorit të rënies së tij, mund të thuhet se Agim Bajrami, ishte rritur, ishte shkolluar, ishte bërë pjesë e veprimtarisë atdhetare ilegale, ishte bërë ushtar i lirisë, edhe për faktin se kujtesa e tij e ideologjisë kombëtare, ishte formësuar duke dëgjuar të parët e tij, bashkëfshatarët e tij, shokët e idealit dhe miqtë e familjes, për padrejtësitë historike që shekujt ia kishin bërë popullit shqiptar. Andaj, nuk është gjë e rastit, se ai edhe organizatës së tij, atje në Zvicrën e largët nga istikamet e ardhshme të Luftës së UÇK-së, i kishte bërë letër që t'i mundësohej e të kthehej në atdhe, të vinte dhe të bëhej pjesë e luftës për liri.

Andaj, nuk është gjë e rastit, se edhe kur ishte i burgosur, edhe kur torturat çnjerëzore bënë përpjekje ta thënin shpirtin e tij, ai jo vetëm i kundërshtonte ata, por edhe nuk e fshihte përpjekjen e tij që me luftë do të çlirohej kjo pjesë e atdheut, që quhej Kosovë.

Andaj, nuk është gjë e rastit, kur pas rënies së Komandantit Legjendar, Adem Jasharit dhe familjes së tij heroike, ai bashkë me luftëtarët të tjerë të lirisë, marrin rrugën e ardhjes, jo vetëm për të luftuar, por edhe për të përgatitur të tjerët për luftë kundër pushtuesit.

Këto dhe karakteristikat e tjera të veprimtarisë së tij atdhetare, bëjnë atë figurën e madhe karakterologjike të heroit, i cili nuk vë asgjë para atdheut, as familjen, as fëmijët, as jetën e tij.

Dhe, Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishte në radhët e saj shumë djem dhe vajza që ishin po ashtu, kaq të gatshëm të sakrifikon çdo gjë, edhe jetën,



për lirinë e kësaj pjese të atdheut. Pra, ai nuk ishte i vetëm. Edhe ditën e rënies, pas një qëndrese heroike, bashkë me të në altarin e lirisë, bien edhe Dëshmorët e kombit, Xheladin Kurtaj dhe Besnik Begunca. Do të thotë, bashkë me komandantin e tyre, bien edhe luftëtarët e lirisë, për ta jetësuar me shembuj se atdheu është mbi të gjitha.

Të rënë për liri janë shkollat e madhe e jetës e dashurisë ndaj atdheut

Çka do të ndodhte me kujtesën kombëtare të Agim Bajramit, pa ngjarjet e mëdha të Arbërisë së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, pa luftërat e tij me Perandorinë më të madhe në botë të asaj kohe, luftëra që kishin zgjatur afro 30 vjet.

Çka do të kishte ndodhur me kujtesën historike të Dëshmorit të Kombit, Agim Bajrami, pa luftërat dhe rëniet e gjyshërve, baballarëve dhe vëllezërve të tij dhe të trimave të tjerë të Kaçanikut?

Këto nuk janë dilema. Janë pyetje për të sqaruar një fakt të vogël historik, se asgjë nuk ka pikur nga qielli në jetën dhe idealin e luftës për liri të luftëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Agim Bajrami. As nuk e kishin përgatitur qendrat stërvitore të shërbimeve evropiane dhe botërore, sepse që të gjithë, deri në vitin 1998 ishin për ruajtjen e mini perandorisë jugosllave.

Pra, lufta për liri dhe çlirim kombëtar e Heroit Agim Bajrami, ishte shkollë e madhe

e traditës së atdheut që të mos jetonte në robëri dhe që gjeografinë kombëtare ta kishte të plotë, aq sa ia kishte caktuar kufijtë Shteti i parë modern shqiptar, me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 1912. Copëtimi i kësaj gjeografie të atdheut të Agim Bajramit, nga qendrat e vendosjes të Evropës së kohës, që nga Kongresi i Berlinit më 1878 e deri të Konferenca e Parisit, më 1920, kishin mbjellë në ndërgjegjen e shqiptarëve, të të gjithë brezave, deri te brezi i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës idealin e madh të luftës për liri dhe bashkim kombëtar.

Mjafton vetëm të lexohen letrat e një numri të Dëshmorëve të Kombit, të lexohen shkrimet e tyre, andaj edhe letrat dhe shkrimet e Agim Bajramit dhe të kuptohet, se ata, përveç luftës për liri, ideal e kishin edhe bashkimin kombëtar. Nuk ka asgjë më të natyrshme se kjo kërkesë, sepse hiqte nga jeta e shqiptarëve padrejtësitë historike që ju kishin bërë të tjerët. Ndryshe, si të kuptohet rënia e Dëshmorëve të Kombit për lirinë e pjesëve të pushtuara të atdheut, si fakt i përjetshëm, dhe kërkesa e qendrave evropiane se Kosova nuk ka të drejtë të bashkohet me askënd, si fakt i përkohshëm, sepse Lufta e UÇK-së, ka hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar, deshën apo nuk deshën qendrat e vendosjes evropiane, deshi, apo nuk deshi politika lojaliste e Tiranës, Prishtinës, dhe Shkupit.

Po me kë do të bashkohej Kosova e çliuar, përveç me shtetin amë, me Shqipërinë, sepse edhe në kohën e Arbërisë së Skënderbeut, edhe në kohën e Katër Vilajeteve, edhe në kohën e Kongresit të Berlinit, edhe në kohën e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913, edhe më vonë, pra edhe sot e gjithë ditën, ishte dhe është pjesë e tërësisë së gjeografisë së Atdheut që quhet Shqipëri. Ndryshe, a do të kishin kuptim, qoftë edhe si frymëzim për rënien e luftëtarit të lirisë, heroit të Kombit, Agim Bajramit, fjalët e Isa Boletinit: Unë jam mirë, kur është mirë Shqipëria.

Nga atje, nga përjetësia e tyre, këtë porosi të madhe që nga pjesa e parë e shekullit nëntëmbëdhjetë, edhe sot në fillim të shekullit njëzetënjë, na përcjellin edhe Dëshmorët e Kombit, ata që e kanë bërë veprim historik mësimin e madh të popujve që luftojnë për liri se atdheu është mbi të gjitha.

Përfundim

Dëshmorin e Kombit, Agim Bajramin, nga përjetësia e tyre e kishin thirrur të parët e familjes së tij, të parët e familjes Duraj, të parët e familjes së Xheladin Kurtajt dhe Besnik Beguncës, Idriz Seferi me luftëtarët e luftës kundër pushtimit turk.

Por, vendimtare kishte qenë thirrja nga përjetësia që i kishte bërë Komandanti Legjendar, Adem Jashari, që e kishte mësuar se nuk ke të drejtë vetëm të thuash, atdheu mbi të gjitha, por edhe të vësh në themelet e lirisë së tij çdo gjë në jetë, edhe jetën tënde.

Dëshmorin Agim Bajrami, kishte marrë rrugën e ardhjes, bashkë me shumë luftëtarë të tjerë, një pjesë e të cilëve po ashtu janë Dëshmorët të Kombit, për ta dëshmuar se kujtesa historike bëhet realitet jetësor vetëm kur atdheu është i lirë, kur hiqen nga jeta e kombit shqiptar padrejtësitë historike që ia kanë copëtuar gjeografinë kombëtare.

Përjetësia e heroit të Kombit, Agim Bajrami, do të ketë kuptim, do të bëhet pjesë e jetës dhe kujtesë kombëtare të brezave të ardhshëm, vetëm kur të përmbushen kërkesat e idealit të tij, që atdheu të jetë i lirë dhe i bashkuar, në mënyrë që të jetë komb modern, siç janë moderne të gjitha kombet e Evropës së qytetëruar.

Prishtinë, 27 nëntor 2018

E jashtëzakonshme

Ishulli me shtëpiza që jepet falas për një profesion

Një grup arkitektësh dizajnuan një ishull me shtëpi të vogla në Norvegji, ku mund të shkohet vetëm me varkë. Projekti fitoi një nga çmimet Architzier 2018, që vlerëson projektet më të bukura në botë. I gjithë blloku i shtëpizave mund të merret me qira



për 3 500 dollarë në javë, por artistët mund të aplikojnë për të qëndruar falas.

FOTO E DITES



Sully, qeni i ish-presidentit të ShBA-së, George H.W, i cili ndërroi jetë javën e kaluar, qëndron përpara arkivolit të Bushit. /Reuters/

E rrallë

Bie dëborë e verdhë

Disa qytete në veriperëndim të Kinës janë mbuluar me dëborë të verdhë, një pamje e rrallë e shkaktuar nga moti i ftohtë dhe stuhitë e rërës në rajon. Videot e filmuara nga banorët në rajonin e Xinjiang tregojnë borën e bardhë të mbuluar nga një shtresë rëre dhe pluhuri, një fenomen i pazakontë që disa e krahasuan me ëmbëlsirën tiramisu.



BARSOLETA E DITËS



- Mami, mami, shokët tallen me mua, thonë se kam këmbë të mëdha!
- Bëjnë shaka, shpirti i mamit. Hajt tani, shko parko këpucët në garazh, se do të hamë drekë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Keni guxuar më shumë


sesa që duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet të merrni mbi vete të gjitha përgjegjësitë.



DEMI

Sot do t'ju duhet të jepni prova për altruizmin

tuaj, sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni mjaft për zemër.



BINJAKËT

Keni kohë që jeni bërë

viktima të konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë sot, do të jetë një ndryshim për mirë.



GAFORRJA

Është një çështje që ju shqetëson prej kohësh

dhe sot ka ardhur momenti t'i jepni fund. Gjithë ky shqetësim do të duket sikur s'ka ekzistuar.



LUANI

Ka projekte që ju kanë zënë

shumë nga koha juaj dhe që do të kuptoni që nuk mund të realizohen. Filloni mbani distancë përpara se të jetë vonë.



IRGJËRESHA

Kontaktet që keni krijuar gjatë

karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh. Çdo gjë do të shkojë mirë.



PESHORJA

Nëse nuk doni ta humbni

mbështetjen e personave pranë jush duhet të jeni më të pranishëm në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



AKREPI

Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin vend

pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbylleni në vetvete.



SHIGJETARI

Keni zgjedhur mënyrën më të mirë

për të qenë vërtet të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm këtë periudhë dhe kjo ju ka ndihmuar.



BRICJAPI

Kohët e fundit keni qenë mjaft të zënë me

jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Mund të krijojë ngecje në karrierë.



UJORI

Sot mund të merrni vendime shumë të

ndryshme nga sa keni thënë më parë sepse në çdo çast do të keni ndryshime të situatave.



PESHQIT

Është mirë të mos

komentoni shumë idetë tuaja te persona që sapo i keni njohur. Mund t'i përvetësojnë si të tyret.

Eddie Murphy bëhet baba për herë të dhjetë



Eddie Murphy është bërë sërish baba. Aktori dhe e fejuara e tij, Paige Butcher, janë bërë prindër të fëmijës së tyre të dytë. Djali Max Charles Murphy që ka lindur ditën e premte, më 30 nëntor, është fëmija i dhjetë për aktorin. "Të dy, si

nëna edhe djali, janë shumë mirë me shëndet", ka thënë zëdhënësi i Murphy për revistën "Us Weekly". 57-vjeçari Murphy kishte bërë të ditur në muajin gusht se 39-vjeçarja Butcher ishte shtatzënë pasi ajo ishte parë në Beverly Hills me barkun e fryrë.

Në hije në fushë, por jashtë saj Chicarito duhet pasur zili



Javier Hernandez, i njohur nga të gjithë si Chicarito, nuk po kalon një moment të mirë në fushën e blertë pasi nuk po luan në vazhdimësi te West Hami, madje po kërkon largimin nga skuadra londineze. Por në jetën

private nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sulmuesin meksikan i cili ka gjetur te modeluesja australiane Sarah Kohan shpirtin binjak. E fejuara e Chicaritos të lë pa fjalë me fotot që publikon në rrjetet sociale.



Ariana Grande: Dashuria nuk ekziston

Ariana Grande ka disa fjalë të forta për të thënë rreth dashurisë pas ndarjes me ish të fejuarin Pete Davidson, por që më pas tha se ajo deklaroi u bë kur ajo ishte shumë e mërziur. Njëpërmjet një postimi në "Twitter"

ajo ka shkruar se dashuria nuk ekziston dhe këtë deklaratë e bëri të shtunën që lamë pas. Kur publikoi titullin e këngës "No Tears Left to Cry", Grande shkroi: "Dashuria e vërtetë nuk ekziston. Shpresoj të keni një ditë të bukur sot!"

Travis Scott dëshiron të studiojë arkitekturë në Harvard

Tani që ai ka pushtuar listat, Travis Scott i ka kthyer sytë kah Harvardi. Të hënën reperi ka bërë publike planet për të aplikuar në universitet. "Unë jam duke aplikuar në Harvard. Me të vërtetë jam shumë i gëzuar", ka thënë reperi. Dikush i afërt me këngëtarin ka konfirmuar për "Page Six" se ai ka ndërmend të aplikojë në programin e arkitekturës së universitetit. Scott kishte folur më parë për ambicien e tij për ta ndjekur universitetin në një intervistë të vitit 2017.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82



PROGNOZA SPORTIVE

RANGERS FC - ABERDEEN

1

EVERTON - NEWCASTLE

1

LYON - RENNES

1

Drita 'harron' titullin, fokusi në Kupë



Duket se Drita përfundimisht ka hequr dorë për ta mbrojtur titullin e kampiones në Superligë. Betim Haxhimusa ka thënë se fokusi i klubit do të jetë në garën e Kupës. "Askush në klub nuk është i kënaqur me atë që kemi treguar në sezonin vjeshtor. Ende jemi brenda objektivit të klubit, pasi jemi në garën e Kupës ku do të kemi përqendrim maksimal", ka thënë Haxhimusa

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kampionia aktuale e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e ka mbyllur sezonin vjeshtor me humbje nga Prishtina (2-0) dhe larg pritshmërive që kishte në fillim të kampionatit. Drita përfundoi e gjashta me 23 pikë, 17 pikë larg vendit të parë në renditjen tabelore. Një nga lojtarët më të mirë në klubin gjilanas, Betim Haxhimusa, ka thënë të martën për "Epokën e re" se askush në klub

nuk është i kënaqur me rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor, por e mira e gjithë kësaj, sipas tij, është fakti se skuadra që drejtohet nga Shpëtim Duro ende është brenda objektivit të klubit. "Askush në klub nuk është i kënaqur me atë që kemi treguar në sezonin vjeshtor. Ende jemi brenda objektivit të klubit, pasi jemi në garën e Kupës ku do të kemi përqendrim maksimal", ka thënë Haxhimusa. Skuadra e Dritës në kuadër të 1/8 së finales në Digitalb Kupën e Kosovës në futboll do të përballet të shtunën nga

ora 12:30 me fituesin e ndeshjes Minatori-2 Korriku.

Betim Haxhimusa, që iu bashkua Dritës në afatin kalimtar të verës nga Gjilani, ka treguar formë të mirë me fanellën e Dritës, duke qenë golashënuesi më i mirë i kësaj skuadre, por edhe ndër lojtarët që ka shënuar më së shumti në elitë. Haxhimusa është i treti në listën e shënuesve me shtatë gola, dy gola më pak se Alban Shillova që është lider. "Në aspektin personal kam pasur paraqitje të mirë, por kam munguar në shumë ndeshje. Kam besim se deri në fund të kampionatit do të arrij të jem i pari në listën e golashënuesve në Superligë", ka deklaruar ai.

Drita në edicionin e kaluar tregoi performancë të jashtëzakonshme duke u shpallur kampionë në elitën e futbollit të Kosovës, pas 15 vjetëve.

SHKURT

Qeveria, 143 mijë euro për xhudon

Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për mbështetjen e Federatës së Xhudos me 143 mijë euro. Vendimin e Qeverisë e ka përshëndetur trajneri Driton Kuka, i cili është i lumtur që xhuidistët dhe kampionia olimpikë do të kenë kushte për stërvitje. "Dinjitetshëm do të stërvitemi tash e tutje. Kryeministri Haradinaj po e kthen dinjitetin edhe te ekipi olimpik. Kampionia olimpikë, falë përkrahjes së sotme të kërkesave tona në mbledhjen e Qeverisë, do të stërvitë në kushte normale për stërvitje", ka shkruar Kuka, i cili ka paralajmëruar se ekipi i xhudos do të punojë për suksese të reja në Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020".

Shumë oferta për Alidemen

Forma e mirë e treguar në sezonin vjeshtor me skuadrën e Llapit dhe tetë golat e shënuara nga Festim Alidema kanë ndikuar që shumë skuadra të Kosovës të shfaqin interesim për transferimin e tij. Ofertat për Alidemen janë nga disa skuadra kroate, një skuadër e Belgjikës dhe një nga Gjermania. Megjithatë, ai do të mbetet pjesë e Llapit edhe në sezonin pranveror, kurse pas përfundimit të kampionatit mund t'i bashkohet një skuadre të madhe evropiane.

Partizanit të Beogradit nuk i lejohet hyrja në Kosovë

Policia e Kosovës ka njoftuar se ia ka refuzuar hyrjen klubit të Partizanit të Beogradit në Kosovë pasi nuk ka poseduar leje për hyrje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Autobusi i cili kishte ardhur nga Serbia në drejtim të RKS-së, në të cilin ka qenë Klubi i Basketbollit 'Partizani i Beogradit', i është refuzuar hyrja pasi nuk ka poseduar leje për hyrje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Federata e Basketbollit e RKS-së). Pas sqarimeve dhe informacioneve zyrtare që u janë dhënë, të njëjtit janë kthyer në drejtim të Serbisë", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Kelmendi: Në Kosovë të gjithë presin nga unë veç medalje të arta

PEJË, 4 DHJETOR - Kampionia olimpikë në xhudo, Majlinda Kelmendi, ka folur për rikthimin e saj pas një kohe të gjatë mungese për shkak të lëndimit. Kelmendi u kthye me sukses në fund të tetorit duke marrë të argjendtën në Grand Slamin e Abu Dhabit, ndërsa pak ditë më pas fitoi të artën në GrandPrix të

Tashkentit. Në një video të publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos, Kelmendi ka thënë se mungesa për 14 muaj ishte shumë e vështirë për të. "I dua aq shumë luftën dhe ushtrimet. Përpiquesha të bëja gjëra të tjera për ta harruar, por nuk funksionoi shumë. As udhëtimet nuk

ndihmuan shumë. As shoppingu s'funksionoi. Asgjë nuk funksiononte", ka thënë ajo. Kelmendi ka treguar se kishte shprehur dëshirën të garonte në Botëror, por nuk ishte lejuar nga trajneri Driton Kuka. Duke folur për pritshmëritë në Kosovë, Kelmendi shtoi se të gjithë presin nga ajo vetëm medaljen e

artë. "Ajo që nuk më pëlqen është se kur marr të argjendtën apo të bronzën, askush nuk më uron. Është xhudo, nganjëherë fiton apo humb, por kur nuk fitoj të artën, askush nuk më uron. Njerëzit janë mësuar ta fitoj të artën andaj kjo më bën pak presion", ka thënë ajo në këtë video.



Fitojnë Oklahoma dhe Golden State

OKLAHOMA, 4 DHJETOR - Oklahoma e pati shumë të lehtë ndeshjen ndaj Detroitit në kampionatin amerikan të basketbollit, NBA. "Thundersat" iu imponuan "pistonsave", duke i mundur me rezultatin 110-83, e protagonistët u bënë Adams me 21 pikë, Paul

George me 17 pikë dhe 10 topa në tabelë, si dhe i zakonshmi Russell Westbrook me 18 pikë. Në krahun tjetër, më i miri në parket te Detroiti ishte Blake Griffin, me 20 pikë, i ndjekur nga Drummond e Jacksoni, me 13 dhe 10 pikë respektivisht.

Golden State e mori veten pas humbjes së fundit që pësoi në NBA, duke fituar sfidën e radhës 128-111 me Atlantën. Clevelandi dhe Brooklyni zhvilluan një ndeshje të rivalizuar mes tyre, në fund të së cilës doli e fituar skuadra e Cavaliersit, që e mbylli

sfidën me rezultatin 99-97 në favor, duke e çuar në pesë numrin e fitoreve sezonale. Houstoni pësoi një tjetër humbje këtë sezon. Skuadra teksane u mposht nga Minnesota 91-103, me "Timberwolvesin" që regjistroi suksesin e 12 sezonal.



Mrekullia e bariut të dhive që arriti majën e botës

PARIS, 4 DHJETOR - Luka Modriqi sot është në krye të futbollit botëror, por shumë vite më parë askush nuk do të thoshte se kjo mund të bëhej realitet. Kjo është mrekullia e Modriqit, nga bari dhish, fëmijë i luftës, refugjat dhe i persekutuar nga serbët, të cilët i vranë gjyshin, te fitimi i "Topit të Artë". Nga qielli i vrenjtur i Zadarit, përmes Bosnjës, Zeprenic, Zagreb, Londër dhe Madrid, ku ai gjeti skenarin më të mirë për ta "puthur" trofeun e lojtarit më të mirë në planet. Luka Modriqi është bërë i njohur edhe përmes dokumentarit të Pavle Balenoviçit, që i referohet kohës mes viteve '89 dhe '90. Një ekstrakt i këtij dokumentari u bë publik nga BBC, ku familja e Modriqit ishte një nga protagonistet njerëzore të rrëfimit. Imazhet tregojnë një nga mjediset, në të cilat ai u rrit, duke ndihmuar familjen e tij në kullota me dhi. Një dokumentar që tregon kontrastin e thellë të atyre viteve me realitetin e sotëm të tij te Real Madridi. Pastaj erdhi fluturimi nga fshati për në Zadarin e tij, ku familja u vendos, duke ikur nga serbët. Jetuan si fillim në "Hotel Kolovare" dhe më pas në "Hotel Iz" derisa gjetën një shtëpi. Luka kaloi orë në parkingun dhe oborrin e tij, respektivisht, me topin e futbollit. Atij nuk i pëlqen ta kujtojë atë kohë. Nga kujtesa preferon t'i shpëtojë imazhet me një top futbollit në këmbë dhe familjen në ato çaste. Nëse Modriqi duhet t'i dedikojë suksesin e tij dikujt, ky është trajneri i parë, mbrojtësi më i madh dhe "babai i tij sportiv", Tomislav Basiq, i cili vdiq në vitin 2014, kur Luka ishte tashmë në Madrid. Kroati kërkoi leje nga klubi për të marrë pjesë në funeralin e trajnerit të parë. Modriqi ëndërroi për të qenë i barabartë me Boban, idhullin e tij, ish-lojtarin e Milanit, kostumin sportiv të të cilit e kishte që fëmijë. Tani, Zvonimir, dora e djathtë e Infantinos në FIFA, e di se Luka e ka tejkuluar atë. Ai, madje, e kujtoi në fjalën përshëndetëse në Londër, si "The Best 2018" tashmë, duke e bërë të qajë Boban. Në Paris, ku mori "Topin e Artë" për vitin 2018, në festë iu bashkua edhe Vanja, gruaja dhe figura thelbësore në karrierën e tij, si dhe dy djemtë. Aty Modriqi jetoi një nga momentet më të veçanta të jetës së tij. Një mrekulli, po ta kesh parasysh trajektoren e jashtëza-



konshme, nga kullotja e dhive në malet e Kroacisë tek "Olimpi" i futbollit, lojtari më i mirë i vitit në botë. Kohë më parë është shfaqur një video, ku Luka pesëvjeçar është kapur duke ruajtur dhitë në Velebi, pranë Zadarit, prej nga është dhe vendlindja e tij. Por si është bërë ajo video? Mos vallë prej atëherë, syri që e ka kapur fëmijën-çoban, e ka ditur se në të ardhmen do të jetë një ndër mbretërit e fushave, që kushton miliona euro? Sigurisht që jo. Materiali është filmuar nga Paul Balenoviç 28 vjet më parë, ndërsa ka dashur të realizojë një dokumentar mbi ujqërit. Pra, është krejt një koincidençë. Luka, 5 vjeç, shfaqet për disa sekonda, pas minutës së dytë të regjistrimit. Vetë autori Balenoviç rrëfeu se si shkoi deri te fokusimi i një çobani, që më pas u bë i famshëm: "Që nga fëmijëria, unë magjepsesha nga natyra dhe kafshët. Ndër to, edhe ujqërit. Ndaj dhe nisa të udhëtoj për t'i studiuar ato nëpërmjet filmimeve". Dhe në rrugëtimin e tij nëpër fshatra, ka njohur edhe familjen "Modriq". "Ata ishin njerëz të mirë. I vizitoja sa herë që shkoja për të filmuar kafshë të egra, natyrën dhe jetën në male. Kështu që një ditë regjistrova dhe fëmijën e tyre, Luka, që ruante një kope dhish. Menjëherë pas vitit 1990, lufta e shkatërroi shtëpinë e tyre. Gjithçka ndryshoi papritur dhe nuk i pashë më. Ata u larguan si shumë njerëz nga ajo zonë. Dhe vetëm pak vite më parë jam informuar mbi atë djalë të vogël, që ishte bërë futbollisti i

njohur, Luka Modriq", përfundon Paul Balenoviç, njeriu që nga pasioni për kafshët i ofron sot botës të shkuarën e pazakontë të një ylli botëror, që mbrëmë fitoi çmimin me prestigjioz individual në futboll, "Topin e Artë". Pa asnjë tatuazh. Pa rrëfime të shumta në gazetatat rozë. Pa krehje të jashtëzakonshme, por me një model flokësh nga e kaluara. Nga jeta private e tij dihet shumë pak, çka në futbollin modern duket sikur të jetë një person jashtë kohës. Kapiteni i Kroacisë me një gjatësi prej vetëm 1.72 metrash duket i tërhequr, flet rrallë dhe nuk ka dëshirë të dalë shpesh para kamerave televizive, në konferencat e shtypit. Jashtë fushës së futbollit, me dëshirë jeton i tërhequr. E ka të vështirë të flasë për veten, pati deklaruar një herë për gazetën gjermane "Die Welt". Por, në fushë ai është shef. "Lufta dhe jeta në kampet e refugjatëve më kanë forcuar", deklaroi Luka Modriq njëherë për mediet. Në fillim të luftës së Kroacisë, në vitin 1991, ai u detyrua të largohet nga fshati i lindjes, së bashku me familjen. Një hap që e ka forcuar për t'u përballur sot me sukses edhe në konkurrencën e një ekipi si Real Madridi. "El Pony", siç e quajnë bashkëlojtarët, mban sot në fanelle numrin 10, një vlerësim i lojërave të mrekullueshme të tij. Luka Modriqi është një artist dhe luftëtar me top. Veçoria e lojës së tij janë pasimet me pjesën e jashtme të këmbës së djathtë, me një saktësi të jashtëzakonshme në gjatësi prej 30-40 metrash.

SHKURT

Motrat e Ronaldos reagojnë pasi Modriqi e fitoi 'Topin e Artë'

Familja e Cristiano Ronaldos ka reaguar ashpër pasi ylli i Juventusit nuk e fitoi "Topin e Artë". Portugezi po shpresonte ta fitonte Topin e gjashtë të Artë pas shkëlqimit sezonin e shkuar me Real Madridin ku fitoi Ligën e Kampionëve, por i pari doli Luka Modriqi që, pos Ligës së Kampionëve, udhëhoqi Kroacinë drejt finales në Kupën e Botës. Ronaldo doli i dyti në votim. "Fatkeqësisht, kjo është bota ku jetojmë, e kalbur, me mafia dhe para të fëlliqura. Fuqia e zotit është më e madhe se e gjithë kjo qelbësirë. Zotit i duhet kohë, por nuk harron", ka shkruar motra e Ronaldos, Elma Aveiro. Motra tjetër e portugezit, Katia, po ashtu ka reaguar në rrjete sociale. "Lojtari më i mirë në botë... për ata që e kuptojnë futbollin sigurisht", ka shkruar ajo teksa ka postuar foton e Ronaldos me këtë trofe.

Përfundoi aventura e Alijit në Rumani

Ka zgatur vetëm një muaj aventura e Naser Alijit te rumunët e Dimanos së Bukureshtit. Palët kanë ndërprerë bashkëpunimin për shkak të problemeve fizike që mbrojtësi shqiptar kishte shfaqur kohët e fundit dhe klubi nuk e priste riaftësimin e plotë të tij. Mbrojtësi është kthyer në Zvicër. Këtë gjë e konfirmon edhe trajneri Mircea Redniç. "Ai ka disa probleme fizike dhe kemi ndërprerë marrëdhënien me të. Aliji është kthyer në Zvicër ku do të përpiqet të zgjidhe këto situatë. E kemi lënë të flasim përsëri në janar dhe mund të kthehet nëse do t'i ketë zgjidhur këto probleme. Nuk na ka kushtuar asgjë afrimi i tij, vetëm disa bileta avioni dhe shpenzime minimale, kontrata u anulua pa probleme", ka thënë trajneri Redniç.

Pas Milanit, Fabregasin e kërkojnë edhe dy klube të tjera

Ish-ylli i Arsenalit dhe Barcelonës, Cesc Fabregas, po kërkohet nga disa skuadra. Fillimisht interesim për lojtarin e Chelsea kishte shfaqur Milani, kurse tash garës i janë shtuar edhe Valencia dhe Vissel Kobe. Mesfushori spanjoll ka pasur pak hapësirë në formacionin e Chelsea në këtë edicion dhe largimi në janar duket shumë i mundur, kurse favorite për të nënshkruar me të është skuadra e Milanit.

Griezmanni: Jam pak i zhgënjyer që nuk e fitova 'Topin e Artë'


Sulmuesi Antoine Griezmann arriti ta fiton Kupën e Botës me Francën dhe Ligën e Evropës me Atletico Madridin, por në garën për "Topin e Artë", fitues doli Luka Modriqi. Sulmuesi francez u shpreh i zhgënjyer që nuk u shpall fitues i "Topit të Artë". "Jam shumë i lumtur me vitin tim 2018. Unë fitova Ligën e Evropës dhe Kupën e Botës, kështu që është një vit i madh. Jam pak i zhgënjyer që nuk e fitova 'Topin e Artë', por ishte një natë e madhe për të festuar fituesit", ka thënë Griezmanni.

City rrezikon përjashtimin nga Liga e Kampionëve


Një klub i madh mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në Ligën e Kampionëve, raporton "Football Leaks". UEFA po përmbyll një hetim dhe mund të marrë masa drastike ndaj Manchester Cityt. Gjithçka ka të bëjë me aspektin financiar dhe nëse gjenden prova të shkeljeve dhe anashkalim i rregullave të 'fair-play' financiar, atëherë qeveria e futbollit evropian mund ta përjashtojë ekipin anglez nga çdo kompeticion evropian, duke nisur nga sezoni i ardhshëm. Në vitin 2014 drejtuesit e Cityt kishin kryer manovra për ta shmanjur FFP (fair-play financiar), për ta shmanjur përjashtimin nga kupat evropiane. Rezultatet e hetimit do të dalin së shpejti dhe klubi e tifozët e "qytetarëve" do t'i marrin vesh masat e ndërmarra.



Autor: GAZMEND MORINA						KËNGËTARJA NË FOTO DHURATA	BARKË QË SHËRBEJN PËR TË MBARTUR MALLRA NËPËR LUM-ENJ (sh.shq.)	KUSAR I ANIJEVE	SHKRONJË GREKE	AKTORJA E FAMSHME WILSON	ZANORE	EPOKA E RE	KLUB I YNI FUTBOLLI	LLOJ PIJE ALKOOLIKE	HAJDE	ANALISTI SHQIPTAR MUSTAFA
NJËSIA PËR TË MATUR FUQINË E RRYMËS ELEKTRIKE												KËNGËTARI ABAZI BASHKËT.				
SHTET NË AMERIKË											QYTET NË SHQIPËRI AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇ-KA TJETËR					
ISH FUTBOLLISTI EDVIN												SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM QYTET I MADH NË GJERMANI (shqip. - shq.)				
GYP NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)									QË ËSHTË LËNË I LIRË QË NISËT VETËM NGA DOBIA E ÇASTIT (fem.)				JOD, AMPER, OKSIGJEN	ZANORE AKTORJA E FAMSHME ITALIANE MUTI		
TATUAZH										SHTET FEDERAL NË SHBA (shqip.) DIJETAR FETAR MYSLIMAN					KRYEQYTETI I SENEGALIT	
AGIM TEJECI								FRIKËSOVE (bised.) PJESË E TELEVIZORIT					AKTORI YNË ... ISLAMI GAMBERINI (shq.)			
BASHKËT.							KANDËRR E VOGËL ME NGJYRË TË ZEZË (shq.) HUQ, VES									
EPOKA E RE	POEMË E VOGËL OSE VJERSHË, NË VARGJE TË RREGULLTA	HUMORISTE E JONA	KILOGRAMET (krah.)	DY ZANORE	MONACO		PJESË E LIMANIT (sh.pashq.) LLOJ HELMI LUFTE				DY ZANORE I RI TAKOVE			EDUARD KROS FUTBOLLISTI TURK BELOZOGU		
FUTBOLLISTI ANGLEZ DEJVID						SANACIONI, PËRMIRËSIMI LUMË NË SHQIPËRI						NJË LLOJ DHEU I BARDHË SI DELTINË EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN				
LETRARI ALI					SHËNDET-ËSORE BREJTËS I VOGËL							MARTIN (shk.) KËNGËTARJA LIBOHOVA				
KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE ... KIM				AKTORJA BUDAKOVA SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)					EMËR YNI MASHKULLI ZANORE					ZANORE ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY		
ANËTARËSIMI NË NJË PARTI POLITIKE							ARË E MBJELLË ME ORIZ (sh.shq.) BASKETBOLLISTI TURK ONAN									DISIPLINË SPORTIVE
DITA E SHËNUAR NË KALENDAR					QILIM I VOGËL QË SHTROHET ANËS VATRËS USHTRIA E SHQIPËRISË				TENISTJA KURNIKOVA EDITA SOPJANI					DY BASHKË-TINGËLLORE		
AKADEMIA E SHKENCAVE			SEKRETARI I OKB-së BAN KI ... VEND I CEKËT NË NJË LUMË				NOTË MUZIKORE LLOJ BIME NARKOTIKE		LLOJ GAZI PA NGJYRË KËNGËTARJA JONË E VJETËR TAKE					"URUGUAI" SMALTI		
EPOKA E RE	PA U NXITUAR, NGADALË POEZIA E DASHURISË				"KENIA" SUPER MODELJA KATE ...			KAMPIONE (Sport) FRIKACAKE, IKANAKE				AKTORJA HOLLIVUDIANE MOORE RADIO TELEVISYEN MALAYSIA				
LETRARI MEKULI					HUMANISTI BIÇIKEMI BASHKËT.				KALLI MISRI KËNGËTARJA CANI							
"RISANI"			NIS TË ZBARDHË DITA GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE				VLERË, DOBI GËZIM I MADH						NËNË (turq.) EPOSI			
AKTORI AMERIKAN WILSON (shqip.)					ORA (turq.) DY ZANORE					AKTORI I NJOHUR GIBSON KËNGËTARJA ZAHARIA					TOTENHAM KËNGËTARJA GJERMANE KONOR (shqip.)	
DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS					E SHTËNË ME DISA ARMË ZJARRI NJËHERËSH METËR, ERBIUM							I PISTË MATH KERNEL LIBRARY				LUAJ
KUNDREJT I VJETËR				DRAMË E SANTORIT LLOJ DRURI					EMËR MASHKULLI MYSLIMAN					AKTORI HOLLIVUDIAN .. PAÇINO BASHKËT.		
MAJA E MPREHTË E NJË MALI					KUNDËRSH-TAR I BOL-SHEVIZMIT RUS ZANORE				KLUB FUTBOLLI NË SUEDI RAVENA				PËR (huaj)			
ZANORE		KASOLLE PËR KAFSHËT (shq.)						KËNGËTARI FEJZULLAHU						LËNDË DJEGËSE E LËNGËT		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit të Komunës
Udhëheqësi i Personelit/Rukovodilac Personal/Head of Personnel

Nr. 111/01-0063019/18
Skenderaj, më 04 Dhjetor 2018.

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, dhe Rregullon nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitën e lirë për një Zyrat për Menaxhimin e Mbeturinave - SHP/060 më 04 Dhjetor 2018, vendosi të shpallë këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e një (1) vendi të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Shërbime Publike.
Pozita e punës: Zyrat për Menaxhimin e Mbeturinave .
Numri i Ekzekutuesve: 1.
Kodi Buxhetor: 18023.
Kategoria funksionale: Profesional 2
Grada e vendit të punës: Koefficienti 7.
Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.
Raporton: Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike, Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike.
Vend ndodhja: Drejtoria për Shërbime Publike, Komuna Skenderaj.

-Përshkrimi i detyrave të punës : Harton raportin vjetor mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzohen në ministri në tre mujorin e parë të vitit vijues ,rregullon, zbaton organizon administrimin e mbeturinave në territorin e Komunës, merr pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve për trajtimin e mbeturinave ,kryen edhe pune të tjera në fushën e menaxhimit të mbeturinave, mbanë evidencën obligatorë për fushë veprimtarinë e menaxhimit të mbeturinave, jep këshilla profesionale për fushën e menaxhimit të mbeturinave, harton plane strategjike në përputhje me planet strategjike të nivelit qendror për fushën e menaxhimit të mbeturinave ,kujdaset për pastërtinë në parqe dhe sheshe publike.

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 2 vite përvojë pune,
- Përveç kushteve të parapara me ligji, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
- Një CV të shkurtër.
- Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
- Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare.
- Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullorës të MAP/DASHC nr. 02/2011.

Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:
- Diplome Universitare Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Fakulteti i Buqësisë se paku 2 vite përvojë.
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Certifikata e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
- Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.

"Shërbimi Civil i Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, i cili i mirëpret të gjitha aplikacionet nga meshkujt dhe femrat të të gjitha komuniteteve të Kosovës" Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderajt. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderaj, në kopje dhe mbetet në arkiv nuk kthehet, konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh, që nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditshme dhe në web-faqen e Komunës. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që vijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen. Konkursi do të shpallet në të dy gjuhët.

Udhëheqësi i Personelit
Armend Gruda

Konform nenit 112 dhe nenit 117, të Ligjit për Shoqërit Tregtare -LIGJI Nr. 06/L -016 PËR SHOQËRITË TREGTARE, shoqëria, "Austrian Hospital" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, me datë 04.12.2018, lëshon këtë;

Shpallje

Bëhet shuarja e Shoqërisë, "Austrian Hospital" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, me Çertifikatën e regjistrimit nr.810013722.

Konform nenit 112 dhe nenit 117, të Ligjit për Shoqërit Tregtare shoqëria, "Austrian Hospital" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, Shpalli;

Të mbyllur-shuaj shoqërinë "Austrian Hospital" Sh.p.k. dhe kërkojnë nga të gjithë të interesuarit, që kanë ndonjë kontest ose kërkesë ndaj kësaj shoqërie të paraqesin kërkesën pranë themeluesit, në afatin brenda 30 ditëve nga dita e publikimit e kësaj shpallje në gazetën ditore.

"Austrian Hospital" Sh.p.k. - Prishtinë.

Proklamacija

Suzbijanje društva ograničenom odgovornoscju "Austrian Hospital" Sh.p.k., sa sedistem u Pristini, sa certifikatom biznisa br. 810013722. Prema članu 112, i 117 zakona o privrednim društvima, vlasnik društva sa ograničenom odgovornoscju 810013722 u Pristini, proklamuje:

Zatvorenog-suzbijanog društva 810013722 i trazi od svih zainteresovanih, ako imaju neki spor ili tuzbu protiv kompanije, da podnese zahtev kod osnivača, u roku od 30 dana od dana objavljivanja ove proklamacije u dnevnom listu.

"Austrian Hospital" Sh.p.k., u Pristini.


Proclamation

Suppression of limited liability company "Austrian Hospital" Sh.p.k., based at Pristina the registration certificate issued nr. 810013722.


According to Article 112, and 118 of the Law on Commercial Societies founders of the society with limited liability "Austrian Hospital" Sh.p.k. Announce;

The closed-erase society "Austrian Hospital" Sh.p.k. and ask all concerned, if they have a contest or claim against the company to submit the application to the founders, in time within 30 days from the date of publication of this advertisement in the daily newspaper.

"Austrian Hospital" Sh.p.k., Pristina.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Udhëheqësi i Personelit-Kabinet Predsendika-Kancelarija Personala
Mayor's office staff leader

Br. 111/01-0063019/18
Skenderaj, 04. decembra 2018 g.

Rukovodilac personala na osnovu člana 3, stav 1 i 2, člana 12, stav 3, člana 18 stav 1, člana 20, stava 1 i 2, Zakona o Javnoj Službi Kosova br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010, za procedure regrutacije u javnoj službi, kao i ovlašćenju za objavljivanje konkursa o MJA preko ISMLJR iz DACS, za slobodno radno mesto Službenik za Menageriranje Odpadaka datum 04 decembra 2018 godine , objavjuje sledeći:

K O N K U R S
O POPUNJAVANJU JEDNOG SLOBODNOG RADNOG MESTA U ORGANIMA SAMOUPRAVE SKENDERAJ

a) **Ime Institucije:** Opština Skenderaj- Direkcija za Javne Usluge;
b) **Naziv radnog mesta:** Službenik za Menageriranje Odpadaka;
c) **Broj izvršilaca:** 1
d) **Budžetski Kod:** 18023,
e) **Funksionalna Kategorija :** Profesional 2
f) **Stepen radnog mesta:** koefficientat 7,
g) **Tip radnog mesta:** KARIJERE puno radno vreme (40) časova,
h) **Raportira:** Rukovodiocu sektora za Javne Usluge-Direktoru Direkciji Javnih Usluga;
i) **Sedište:** Direkcija za Javnu Uslugu, Opštine Skenderaj.

Opis Radnih Zadataka: Izrađuje godišnji izveštaj o upravljanju otpadaka, kojeg predaje u Ministarstvu u prvu trogodišnju sledeće godine, regulira, sprovodi i organizuje upravljanje otpadaka na teritoriju opštine Skenderaj, Učestvuje u donošenju odluka za izgradnju objekata, ozvrši i druge poslove u oblastima menageriranja otpadaka, drži evidencija za obavezneke od oblasti menageriranja otpadaka, Daje profesionalne savete u oblasti menageriranja otpadaka, izrađuje strateške planove u skladu palnovima za menageriranje otpadaka za oblast menageriranja smeća, stara se za higiju u zeleništa na teritoriju opštine Skenderaj, stara se za higijenu u javnim zeleništa i parkovima.

Kavifikacija: Universitetska diploma, 2 godine radnog iskustva
- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi po pritiskom na multietničkoj društvu;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog perioda 12 meseca, Pravilnika MJS/DACS br. 02/2011 za probni rad javnih službenika.

Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:
- Universitetska diploma, Fakultet Rudarstva, Fakultet Poljoprivrede , najmanje 2 godine radnog iskustva;
- Dokaz o radnom iskustvu ;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda;

"Civilna Sluzba Kosova je na usluzi svih stanovnika Kosova i poželjno očekuje aplikacije od muskaraca i žena od svih Zajednica Kosova"
Aplikacije se mogu dobiti u CUG-u (Arhivi) br. 1, u prostorijama opštine Skenderaj.
Dokumentacija se predaje u CUG-u opštine Skenderaj, u roku od 15 dana od dana objavljivanja ovog konkursa na javnim srdstvima informisanja i ueb stranice opštine Skenderaj/Srbica. Nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati. Predata dokumentacija neće se vratiti strankama, jedno kopije ostaje u Arhivi za dalji postupak. Konkurs se objavlja na ova jezika.

Rukovodilac Personal:
Armend Gruda, s.r.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Engineering" Sh.p.k Suharekë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.12. 2018 në ora 11:00 në hapësinat e administratës të kompanisë "Engineering" në Rr. Magjistrale Prishtinë - Ferizaj 100m nga rrethi i QMI-së, do të organizohet debat publik nga kompania "Engineering" Sh.p.k Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar Financiar në MKRS-Prizren

Kategoria funksionale-Koeficienti : 7

Numri i referencës: 56/2018

I përgjigjet: Udheqesit për Buxhet dhe Financa në MKRS

Vendi: Prizren

Lloji i kontratës: "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj).

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udheqesit për Buxhet dhe Financa në DFSHP

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik, minimum një (vit) përvojë pune profesionale.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 12.12.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu br. 03/L-212, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Br. 03/L-149, i Uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Zvaničnik Finansije u MKOS-Prizren

Funkcionalna Kategorija: Koeficientat 7

Broj referencije: 56/2018

Odgovoran je: Rukovodiocu za Buzdet i Finansije u DFGU

Mesto: Priština

Vrsta ugovora: "Sporazum o posebnim uslugama" (vremensko trajanje 6 meseci)

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodioca za Buzdet i Finansije u DFGU, izvršava dole navedene:

Zadatke i odgovornosti

1. Razvija i postiže saglasnost za planove rada i rokove sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga i proizvoda;
2. Izvršava specializovane zadatke, prema zahtevu, iz specifične profesionalne oblasti u podudarnosti sa dotičnim zakonom, pravilnicima, politikama i procedurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Izvršava zadatke iz specifične profesionalne oblasti sa jednim razložnim stepenom nezavisnosti, sa povremenim nadzorom i uputstvima;
4. Vrsi istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju uputstava za razmatranje od najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti. Kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar institucije i van nje za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa, u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične, profesionalne oblasti, koji se razložno mogu zahtevati s vremena na vreme.

Zahtevao obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko poznavanje specifične, profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Poznavanje zakona i pravilnika koji se sprovode;
3. Sposobnost u komuniciranju za planiranje rada, eventualna koordinacija sa radnim osobljem;
4. Sposobnost za istraživanje, analitiku, procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru, u aplikovanju programa (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Univerzitetska diploma, ekonomski pravac, minimum jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na određeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 8 (osam) dana .

Zadnji datum za aplikovanje je: 12.12.2018

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Podnošenje Zahteva: Aplikacije se preuzimaju sa Ueb stranice MKOS-a, i predaju u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte na broj: 038211449 ili 038211921 (ili na web-stranici <http://www.mkrs-ks.org/>).

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "DITURIA" Ivajë
Komuna: Kaçanik
Data: 04.12.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/148-CS/1.3	Trajnim: Zbatimi i TI në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "DITURIA", Ivajë Kaçanik.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Zbatimi i Teknologjisë Informative në mësimdhënie (World, Exel dhe Power Point)

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "DITURIA", Ivajë Kaçanik, më së largu deri më 13.12.2018.

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Nexhadi Luta
Telefoni : 044 224 878
E-mail: nexhadiluta@hotmail.com

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt: 044 248 173; 044 200 604;
044 375 333



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

